



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 230 Akti

Nr. 330 Vendimi
Tiranë, më 11.1.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj **Kryesues**
Pamela Qirko **Relatore**
Valbona Sanxhaktari **Anëtare**

asistuar nga sekretare gjyqësore znj. Gledis Hajdini, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. Branko Hrvatin, në Tiranë, në datat 24 dhjetor 2020, ora 10:00 dhe 6 janar 2021, ora 12:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Pelivan Malaj**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr.76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Pamela Qirko, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve bazuar në nenin 179/b, paragrafi 5 të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” (të ndryshuar) dhe në nenin 3, pika 5 dhe nenin 5, pika 1 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Pelivan Malaj, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio* në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) më 15.11.2018 zhvilloi procedurat e shortit të shpërndarjes së çështjeve në trupa gjykues, nga ku rezultoi se subjekti do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 4, i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Valbona Sanxhaktari dhe Lulzim Hamitaj. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionere, znj. Pamela Qirko.

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 21.11.2018 u caktua me mirëkuptim kryesues z. Lulzim Hamitaj, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

5. Në zbatim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, për z. Malaj nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë, në përputhje me kreun IV të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (këtu e në vijim “ILDKPKI”); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (këtu e në vijim “DSIK”) dhe komisioni i vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale në Këshillin e Lartë të Prokurorisë (këtu e në vijim “KLP”).

10. ILDKPKI-ja, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë, ka dërguar një raport¹ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti është konstatuar se:

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- ka kryer fshehje të pasurisë;
- ka kryer deklarim të rremë dhe;
- nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

11. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim ka dërguar raportin² e mbajtur për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

12. Komisioni i vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale në KLP ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

13. Në vijim janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara nga pika 5 e nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vlerësoi se ato arrijnë nivelin e provueshmërisë dhe në datën 24.11.2020 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht, duke u bazuar vetëm në kriterin e pasurisë për subjektin e rivlerësimit; (ii) njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40, 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

15. Subjekti i rivlerësimit në datën 26.11.2020 u njoftua mbi të drejtën për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit të zhvilluar kryesisht nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 7.12.2020.

¹ Akti i kontrollit nr.*** prot., datë 8.1.2018.

² Raporti nr. *** prot, datë 30.10.2017.

16. Në vijim, pasi mori në shqyrtim kërkesën për riçeljen e hetimit, të depozituar nga subjekti i rivlerësimit³, në datën 22.12.2020 trupi gjykues vendosi⁴ mospranimin e saj.

17. Subjekti ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit administrativ në datën 21.12.2020.

18. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCAT DËGJIMORE

19. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë me *e-mail*, në datën 2.12.2020.

20. Seanca e parë dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më 24.12.2020, ora 10:00, në ambientet e Pallatit e Koncerteve (ish-Pallati Kongreseve), salla B, kati 0, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin.

21. Me fillimin e seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit depozitoi kërkesë për përjashtimin e trupit gjykues, në këto kushte, u vendos ndërprerja e saj.

21.1. Shqyrtimi i kërkesës së subjekti i rivlerësimit u bë nga një tjetër trup gjykues, i cili vendosi mospranimin e saj.

22. Subjekti i rivlerësimit u ftua sërish në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë me *e-mail*, në datën 30.12.2020.

23. Seanca e dytë dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më 6.1.2021, ora 12:30, në ambientet e Pallatit e Koncerteve (ish - Pallati Kongreseve), salla B, kati 0, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin.

23.1. Gjatë kësaj seance u relatuan rezultatet e hetimit kryesisht. Subjekti i rivlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin për procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve mbi rezultatet e hetimit për kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Komisioni riçeljen e hetimit edhe për dy kriteret e tjera.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

24. Zoti Pelivan Malaj nuk ka qenë gjithmonë bashkëpunues gjatë këtij procesi rivlerësimi, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, duke mos iu përgjigjur drejtpërdrejt të gjitha pyetjeve të dërguara gjatë hetimit administrativ apo shpjegimeve të kërkuara me dërgimin e rezultateve të hetimit, si edhe duke mos depozituar në kohë dokumentacionin e kërkuar nga Komisioni.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

25. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin

³ Kërkesë e depozituar në Komision në datën 21.12.2020, nëpërmjet postës elektronike.

⁴ Vendimi i ndërmjetëm nr. 4, datë 22.12.2020.

e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

25.1. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

25.2. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

25.3. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës. Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

25.4. Por, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017⁵ dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

26. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar “Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e subjektit, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportin e kontrollit të figurës, të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja; (ë) denoncimet e publikut; dhe (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

⁵ “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

A. VLERËSIMI I PASURISË

27. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së subjektit dhe ligjshmërisë së burimit dhe të krijimit të saj.

27.1. Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”, të paraqitur më parë në ILDKPKI, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit.

27.2. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqëndruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, si edhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

27.2.1. Në deklaratën “Vetting” (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI më 30.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë deklaruar pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme. Konstatohet se nëpërmjet kësaj deklarate subjekti ka deklaruar edhe pasuri, të cilat, referuar dokumentacionit ligjor të administruar në dosje, nuk i kishte në pronësi apo përdorim të tij në momentin e deklaramit. Fillimisht, Komisioni u fokusua në pasuritë, të cilat subjekti ka patur në pronësi apo i ka disponuar në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting”.

28. Pasuria e llojit “apartament”⁶, me sipërfaqe 120 m², ndodhur në objektin e ndërtuar nga subjekti “****” sh.p.k., në bulevardin “****”, lagjja “****”, Vlorë, blerë në datën 31.1.2005, për vlerën 31,000 dollarë, në bashkëpronësi me bashkëshorten.

28.1. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar: (i) të ardhurat nga shitja⁷ e apartamentit të përfituar më parë nga privatizimi; dhe (ii) të ardhurat e tij si avokat.

28.2. Deklarimi i kësaj pasurie në vite: nga deklarata fillestare⁸ e pasurisë konstatohet se subjekti ka deklaruar pasurinë e llojit “apartament” në bashkëpronësi me bashkëshorten, me sipërfaqe 120 m², i ndërtuar në vitin 1998, me vlerë 4,500,000 lekë, i ndodhur në rrugën “****”, pallati “****”, Vlorë. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar: (i) shumën 2,700,000 lekë nga shitja e apartamentit të përfituar nga privatizimi; dhe (ii) shumën 1,800,000 lekë nga të ardhurat nga avokatia.

28.3. Konstatimi i ILDKPKI-së për këtë pasuri: i) mungesë në procesin e rivlerësimit të kontratës së porosisë/blerjes së apartamentit në lagjen “****”, Vlorë. Deklaruar në “Vetting” çmimi 31,000 dollarë, në vitin 2003, deklaruar 4,500,000 lekë, sipas kontratës së blerjes, administruar nga përgjigjja e ZVRPP-së Vlorë dhe dokumentacioni në ILDKPKI, çmimi 32,000 dollarë; ii) deklarim i rremë në DPV/2003 i çmimit 2,700,000 lekë të shitjes së apartamentit të privatizuar, në rrugën “****”, lagjja “****”, Vlorë, pasi në kontratën e paraqitur në “Vetting”, çmimi i shitjes është 1,900,000 lekë (përdorur si burim për blerjen e apartamentit në Vlorë).

⁶ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës aneksin ****në dosjen e ILDKPKI-së; (i) kartelën e pasurisë së paluajtshme; (ii) vërtetim nga dokumentet hipotekore të datës 17.6.2004; dhe (iii) kontratë shitjeje nr. ****, datë 27.10.1999.

⁷ Kontratë shitjeje nr. **** kol., nr. *** rep., datë 27.10.1999.

⁸ Deklaratë e dorëzuar në ILDKPKI në datën 19.3.2004.

Hetimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri

28.4. ZVRPP-ja Vlorë⁹, konfirmon se në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij është e regjistruar pasuria e llojit “apartament”, me sipërfaqe 120 m², me nr. ***, vol. ***, fq. ***, me sipërfaqe 120 m².

28.5. Sipas kontratës¹⁰ së datës 11.1.2005, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë blerë nga shoqëria “****” sh.p.k., pasurinë e llojit “apartament banimi”, me sipërfaqe 120 m², të ndodhur në kompleksin ndërtimor “****”, në qytetin e Vlorës, përballë universitetit. Në nenin 5 të kësaj kontrate, ndër të tjera, përcaktohet se *palët në kontratë kanë rënë dakord që çmimi i shitjes së këtij apartamenti është 32,000 dollarë dhe se likuidimi i çmimit të shitjes është realizuar mes tyre tërësisht.*

28.6. Sa më sipër, rezultojnë pasaktësi/mospërputhje në deklarin e çmimit të blerjes së kësaj pasurie, pasi në deklarin fillestar të pasurisë çmimi i blerjes është deklaruar në vlerën 4,500,000 lekë, në deklaratën “Vetting” është deklaruar 31,000 dollarë, ndërkohë që në kontratën e datës 11.1.2005, çmimi i blerjes së kësaj pasurie është 32,000 dollarë.

28.7. I pyetur nga Komisioni lidhur me këto mospërputhje, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se¹¹ *marrëveshja me ndërtuesin për blerjen e apartamentit është bërë në vitin 1999 dhe po në këtë kohë ka hyrë në apartamentin pothuaj të përfunduar. E ka marrë në disponim këtë banesë në vitin 1999, menjëherë pas shitjes së banesës së privatizuar 1+1, meqenëse nuk ka pasur banesë tjetër. Çmimi i blerjes së këtij apartamenti ka qenë 32,000 dollarë amerikanë dhe shumica e pagesës së vlerës në dollarë është bërë në vitin 1999 me paratë (2,700,000 lekë) e përfituara nga shitja e apartamentit të privatizuar. Konvertimi është bërë në atë kohë, me kursin e asaj kohe. Meqenëse në apartamentin e tij kishte ende pak punime të papërfunduara, pasi ai nuk kërkoi vënien e grilave të jashtme të dritareve, nuk i është kërkuar në pagesë shuma 1,000 dollarë. Pra, vlera e plotë e paguar prej tij në dollarë ka qenë 31,000 dollarë.*

28.8. Për të provuar pagesat e kryera në favor të shoqërisë ndërtuese në vitin 1999, subjekti i rivlerësimit ka depozituar¹² kopje të disa mandatpagesave të shoqërisë “****” sh.p.k., të dhënat përmbledhëse të të cilave pasqyrohen në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 1

Mandati		Përshkrimi	Shuma në USD
Numër	Datë		
107	25.2.1999	<i>Për apartament “****”</i>	10,000
210/2	6.5.1999	<i>Për blerje apartamenti në ***</i>	5,000
282/1	11.6.1999	<i>Për blerje shtëpie pallati në ***</i>	10,000
384	20.9.1999	<i>Apartament në ***</i>	5,000
385	20.9.1999	<i>Apartamenti në ***</i>	1,000
TOTALI			31,000

⁹ Shkresa nr. ***prot., datë 8.3.2019.

¹⁰ Kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.1.2005.

¹¹ Përgjigjet e pyetësorit nr. 2.

¹² Në vijim të provave të dërguara për pyetësorin nr. 2, dërguar me e-mail-in e datës 12.2.2020.

Analiza e burimit të të ardhurave të deklaruara për krijimin e kësaj pasurie

29. Të ardhurat nga shitja e apartamentit të përfituar më parë nga privatizimi

29.1. Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti, pjesë e dosjes së ILDKPKI konstatohet se, në datën 27.10.1999 subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë shitur¹³ apartamentin me sipërfaqe 57.8 m², të ndodhur në rrugën “***”, lagjja “***”, Vlorë, apartament ky i përfituar më parë me ligjin e privatizimit, për vlerën 1,900,000 lekë.

29.2. Sikurse u pasqyrua më sipër, në deklaratën “Vetting” janë referuar si burim krijimi i pasurisë objekt vlerësimi, të ardhurat e përfituara nga shitja e këtij apartamenti, por nuk është përcaktuar vlera, ndërsa në deklaratën fillestare të pasurisë është deklaruar si burim shuma 2,700,000 lekë nga shitja e apartamentit të përfituar nga privatizimi.

29.3. Duke marrë në konsideratë mandatpagesat e depozituara si prova nga vetë subjekti gjatë hetimit administrativ, duket se si burim krijimi për blerjen e kësaj pasurie nuk mund të ketë shërbyer vlera e plotë e përfituar nga shitja e këtij apartamenti.

29.4. I pyetur nga Komisioni lidhur me këto konstatime, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se *me blerësit e këtij apartamenti kanë qenë komshinj në të njëjtin kat të pallatit. Meqenëse e kishte shumë të domosdoshme zgjerimin për banim, për shkak të rritjes në moshë të dy fëmijëve (vajza 19 vjeç dhe djali 17 vjeç), kanë rënë dakord që atyre t’u shesin apartamentin e tyre. Pas disedimeve, kanë rënë dakord për çmimin e shitjes 2,700,000 lekë, të cilat janë paguar cash në dorë kohë përpara, meqë u duheshin paratë për të paguar blerjen tek firma “***”. Kontrata e shitjes është bërë disa muaj më vonë, pasi ata ishin vendosur me banim tek banesa e re. Me praktikën dokumentare të shitjes së banesës është marrë bashkëshortja, pasi në atë kohë kryente detyrën e drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Vlorë dhe, periudha ka qenë shumë e ngarkuar me punë. Mban mend që ka shkuar tek noteri pasi gjithë dokumentacioni ishte bërë gati dhe ka nënshkruar të gjitha kopjet e kontratës pa i lexuar. E gjithë shuma e çmimit të shitblerjes ishte përfituar prej tyre në formën e paradhënies, jashtë zyrës noteriale, fakt ky që e bënte formal nënshkrimin prej tij të kontratës. Më vonë, edhe kur është vënë në dijeni të kopjes së aktit noterial, përsëri në deklarin e tij i është referuar vlerës së vërtetë të shitjes.*

29.5. Për të mbështetur deklarin e tij, subjekti ka depozituar si provë të re kopje të deklaratës noteriale¹⁴ të datës 4.2.2020, nëpërmjet së cilës shtetasi F.M., (blerësi i banesës), ndër të tjera, ka deklaruar se *kur u vendos shitblerja, pranuan me njëri-tjetrin që çmimi i shitblerjes së pasurisë apartament të ishte në shumën 2,700,000 lekë, dhe aq u ble prej tij dhe bashkëshortes. Këto para janë paguar prej tyre disa kohë përpara se të bëhej kontrata.*

29.6. Për sa më sipër, Komisioni konstaton se: i) në deklaratën fillestare të pasurisë, subjekti ka kryer deklarin të pasaktë lidhur me vlerën e përfituar nga shitja e kësaj pasurie; ii) në deklaratën fillestare të pasurisë dhe në deklaratën “Vetting”, subjekti ka kryer deklarin të pamjaftueshëm, duke deklaruar si një nga burimet e krijimit të pasurisë objekt vlerësimi të ardhurat nga shitja e apartamentit të përfituar më parë nga privatizimi.

¹³ Kontrata nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.10.1999.

¹⁴ Deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.2.2020, depozituar në vijim të provave të dërguara për pyetësorin nr. 2, dërguar me e-mail-in e datës 7.2.2020.

29.7. Gjithashtu, rezulton se subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues ligjor të ardhurat shtesë të pretenduara si të përfituara mbi çmimin e vendosur në kontratën e shitjes së vitit 1999 të banesës në Vlorë, dhe as shlyerjen e detyrimeve tatimore për këto të ardhura.

29.8. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet/shpjegimet e tij përfundimtare dhe depozitimim e provave të reja të mundshme në lidhje me konstatimet e bëra nga Komisioni.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimi

30. Subjekti i rivlerësimit u qëndron shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ për vlerën e shitjes së kësaj pasurie dhe periudhën e marrjes në dorëzim të të ardhura të përfituara nga shitja e saj, duke parashtruar gjithashtu se *deklarimi i tij për vlerën e shitjes së apartamentit të ndodhur në lagjen “****”, në shumën 2,700,000 lekë, edhe pse nuk përputhet me vlerën e shënuar në kontratë, është i vërteti. Gjithashtu subjekti ka argumentuar se megjithëse nuk ka akses të bëjë këqyrje të dokumentacionit të ndodhur në ZVRPP-në Vlorë, të dhënat tregojnë se në periudhën që është realizuar shitja e apartamentit të tij, rreth 80% e akteve noteriale redaktoheshin nga noterët në vlerën 1,900,000 lekë, pavarësisht llojit të apartamentit, cilësisë, vendit ku ndodheshin dhe sipërfaqes së banimit. PAGESA E DETYRIMEVE TATIMORE NË LIDHJE ME SHITJEN E KËSAJ BANESE DHE DOKUMENTACIONI I ËSHTË BASHKËNGJITUR PRAKTIKËS SË REGJISTRIMIT, E CILA ËSHTË DORËZUAR NË ZRPP-NË (TANI KADASTRA) VLORË. KJO PËR SHKAK SE, SIPAS LIGJIT, PA KRYER KËTO PAGESA, NUK PRANOHEJ REGJISTRIMI I PASURISË PAS ÇDO TRANSAKSIONI.*

Vlerësimi përfundimtar i Komisionit

31. Nga analiza e dokumentacionit të administruar për transaksionin e kryer për shitjen e pasurisë së përfituar më parë nga privatizimi, si edhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti gjatë hetimit administrativ dhe me dërgimin e prapësimeve, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit. Vërehet se shpjegimet e tij janë kryesisht të karakterit deklarativ, të pambështetura në dokumentacion provues. Subjekti nuk arriti të provojë tej çdo dyshimi të arsyeshëm shitjen e kësaj pasurie me një çmim më të lartë nga ai i përcaktuar në kontratë dhe pagesën e detyrimeve tatimore për këto të ardhura të pretenduara, dhe as faktin e marrjes paradhënie të të ardhurave nga shitja e kësaj pasurie, para nënshkrimit të kontratës.

31.1. Sa më sipër, Komisioni vlerëson se, të ardhurat nga shitja e banesës së përfituar më parë nga privatizimi, në shumën 1,900,000 lekë, nuk mund të kenë shërbyer si burim krijimi i pasurisë objekt vlerësimi.

32. Të ardhurat nga ushtrimi i aktivitetit privat, si avokat

32.1. Në deklaratën “Vetting”, në rubrikën ku pasqyrohen të ardhurat, për periudhën prill 1993- shkurt 1998, subjekti ka deklaruar të ardhura të përfituara nga profesioni/aktiviteti si avokat shumën 8,700,000 lekë (mesatarisht 150,000 lekë në muaj, pa dokumentacion të plotë). Ndërsa për periudhën 1 dhjetor 1999 – 30 prill 2003, të ardhura totale të përfituara nga profesioni/aktiviteti si avokat në shumën 8,200,000 lekë (mesatarisht 200,000 lekë në muaj – pa dokumentacion të plotë).

32.2. Për të dokumentuar aktivitetin e avokatisë dhe të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga ushtrimi i këtij aktiviteti, subjekti, ndër të tjera, ka depozituar kopje të dokumentacionit

si vijon¹⁵: (i) vendim i datës 24.4.1993 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për regjistrimin si subjekt juridik privat për zhvillimin e veprimtarisë private në fushën e avokatisë; (ii) leje për ushtrimin e profesionit të avokatit, lëshuar në datën 13.4.1993 nga Këshilli Mbikëqyrës i Avokatisë; (iii) licencën e avokatit, lëshuar më 28.12.2000; (iv) leje për ushtrimin e aktivitetit për periudhën janar 1996 deri në datë 31.12.1996 me objekt kryesor të veprimtarisë “Avokat dhe fotokopje”, lëshuar nga Dega e Tatim Taksave Vlorë; (v) certifikatë regjistrimi në organin tatimor, nr. *** serial, për ushtrimin e aktivitetit si person fizik me dy kode fiskale (*** dhe ***), por pa të dhëna identifikuese të subjektit; (vi) fletënjoftim tatimi me nr. *** regjistrimi, datë 1.1.1994 (profesioni avokat), për periudhën 1.1.1994 - 31.12.1994; (vii) fletënjoftim tatimi me nr. *** regjistrimi, datë 8.4.1994 (fotokopje), duke filluar nga tremujori i dytë llogaritja e tatimit; (viii) fletënjoftim tatimi për periudhën 1.1.1995-31.12.1995 (profesioni avokat); (ix) fletënjoftim tatimi (pa numër regjistrimi) për periudhën 1.1.1995 - 31.12.1995 (profesioni fotokopje); (x) fletënjoftim tatimi me numër *** dhe *** regjistrimi, datë 2.3.1996 (për profesionin avokat dhe fotokopje); (xi) fletënjoftim me numër *** dhe *** regjistrimi, datë 29.1.1997, (për profesionin avokat dhe fotokopje) për periudhën 1.1.1997 - 31.12.1997; (xii) mandatarkëtimi për pagesë sigurime shoqërore, me nr. ***, datë 15.3.1996; (xiii) mandatarkëtimi për pagesë sigurimesh shoqërore, me nr. ***, datë 14.6.1996; (xiv) mandatarkëtimi për pagesë sigurimesh shoqërore, datë 16.9.1996; (xv) mandatarkëtimi për pagesë sigurimesh shoqërore, me nr. ***, datë 31.12.1996; (xvi) mandatarkëtimi për pagesë tatim taksash, nr. ***, viti 1996; (xvii) mandatarkëtimi për pagesë tatim taksash, nr. ***, viti 1996; (xviii) mandatarkëtimi për pagesë tatim taksash, nr. ***, viti 1996; (xix) mandatarkëtimi për pagesë tatim taksash, nr. ***, viti 1996; (xx) librezë pune.

32.3. Konstatimi i ILDKPKI-së: mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të ardhurat e deklaruara nga aktiviteti privat si avokat i subjektit Pelivan Malaj.

Hetimi i kryer nga Komisioni

33. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve¹⁶ dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë¹⁷ nuk konfirmojnë të dhëna të regjistrimit në organin tatimor të subjektit të rivlerësimit. Më konkretisht, DRT-ja Vlorë informon se subjekti i rivlerësimit nuk rezulton i regjistruar si tatimpagues në regjistrat e këtij institucioni.

33.1. QKB-ja informon se shtetasi Pelivan S., Malaj, i datëlindjes 1955, figuron i çregjistruar si person fizik, me vendimin nr. ***, datë 13.5.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke vënë në dispozicion kopje të këtij vendimi.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar, duket se subjekti i rivlerësimit është regjistruar për herë të parë si person fizik në gjykatë me vendimin gjyqësor nr. ***, datë 20.10.1994. Gjithashtu, vërehet se subjekti ka bërë një kërkesë të dytë për regjistrimin e tij në gjykatë si person fizik dhe se në tetor të vitit 1999 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë sërish ka vendosur regjistrimin si person fizik të z. Pelivan Malaj, për të ushtruar veprimtari private në fushën e avokatisë.

¹⁵ Dokumentacioni pjesë e dosjes së ILDKPKI-së – aneksi ***.

¹⁶ Shkresa nr. *** prot., datë 6.2.2019, në përgjigje të kërkesës së bërë nga Komisioni me nr. *** prot., datë 30.1.2019.

¹⁷ Shkresa nr. ***prot., datë 24.1.2020.

33.2. DRSSH-ja Vlorë¹⁸ informon se z. Pelivan S., Malaj rezulton të jetë i siguruar si person fizik, me numër *** “Avokat”, për periudhën: (i) 1.10.1993 deri më 31.12.1996; (ii) 1.10.1997 deri më 31.12.1998; dhe (iii) 20.10.1999 deri më 31.3.2002¹⁹.

Gjithashtu, janë pasqyruar të dhëna për pagat mbi të cilat janë derdhur kontributet për periudhën 1994 – 2002, të përmbledhura shumat totale vjetore si vijon: (i) për vitin 1994 shuma 30,720 lekë; (ii) për vitin 1995 shuma 38,160 lekë; (iii) për vitin 1996 shuma 49,200 lekë; (iv) për vitin 1997 (periudha tetor - dhjetor) shuma 14,730 lekë; (v) për vitin 1998 shuma 71,350 lekë; (vi) për vitin 1999 (periudha tetor - dhjetor) shuma 15,505 lekë; (vii) për vitin 2000 shuma 86,508 lekë; (viii) për vitin 2001 shuma 97,014 lekë; dhe (ix) për vitin 2002 shuma 25,188 lekë. Në total, paga mbi të cilën është paguar kontributi për gjithë këto vite është në vlerën 428,375 lekë.

33.3. Subjektit iu kërkua të japë shpjegime dhe të dokumentojë me dokumentacion justifikues ligjor të ardhurat e pretenduara nga aktiviteti i avokatisë, të cilat paraqiten si burim krijimi i disa pasurive. Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, deklaroi se²⁰ *sipas ligjeve të kohës, është regjistruar në Degën e Tatim Taksave Vlorë dhe ka dhënë kontributet për sigurimet shoqërore....Të ardhurat nga avokatia kanë qenë ato që ka bërë në deklaratat periodike.*

33.4. Subjekti ka depozituar si provë informacionin dhe dokumentacionin e administruar prej tij nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore²¹, i cili referon informacion të njëjtë të administruar më parë nga Komisioni nga DRSSH-ja Vlorë. Gjithashtu, subjekti pretendon se disponon dokumentacion të bollshëm nga veprimtaria e tij si avokat, përfshirë redaktime kontrata shitjesh, huadhëniesh, aktmarrëveshje si edhe vendime gjyqësore kryesisht të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Gjykatës së Apelit Vlorë.

33.5. Siç u pasqyrua më sipër, në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar si burim krijimi të pasurisë të ardhurat nga avokatia, pa specifikuar shumën përkatëse të tyre, ndërsa në deklaratën fillestare të pasurisë ka deklaruar të ardhurat nga avokatia në shumën 1,800,000 lekë. Nga analiza e dokumentacionit të administruar në dosje duket se subjekti nuk justifikon me dokumentacion ligjor të ardhurat e pretenduara nga aktiviteti i avokatisë. Nuk gjenden të dhëna të regjistrimit të tij si tatimpagues, si rrjedhim, as deklarimi i qarkullimit, as pagesa e detyrimeve tatimore dhe fitimi neto i realizuar nga aktiviteti tregtar, sipas legjislacionit në fuqi.

33.6. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumente/shpjegime dhe për të depozituar prova të reja të mundshme, për të provuar regjistrimin në organin tatimor, ushtrimin e aktivitet tregtar dhe të ardhurat e gjeneruara nga ky aktivitet, të deklaruara si një nga burimet e krijimit të pasurisë objekt vlerësimi dhe disa pasurive të tjera.

33.7. Në prapësimet e tij, subjekti i rivlerësimi, ndër të tjera, ka parashtruar se: “[...] *Pas mbërritjes së rezultateve të hetimit administrativ, prej meje janë bërë të tjera përpjekje edhe me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Vlorë, por prej tyre, me shkresën nr. ***, datë 4.2.2020, ridërguar me shkresën nr. ***, datë 26.2.2020, është konfirmuar fakti se unë subjekti i rivlerësimit Pelivan Malaj kam qenë i regjistruar si tatimpagues i biznesit të vogël me kodin*

¹⁸ Shkresa nr. ***prot., datë 28.1.2020.

¹⁹ Vërtetimi nr. *** prot., datë 28.1.2019 (mendohet të jetë lapsus shënimi në vërtetimi i vitit 2019, duke qenë se ky vërtetim shoqëron shkresën e DRSSH-së Vlorë, të datës 28.1.2020).

²⁰ Përgjigjja e pyetjes nr. 4, të pyetësorit nr. 2.

²¹ Shkresa ISSH-së, Drejtoria Rajonale Vlorë me nr. *** prot., datë 3.2.2020 dhe dokumentacioni shoqëruar i saj.

*fiskal *** dhe kam kryer pagesa pranë organit tatimor për vitet 1998, 2000, 2001 dhe 2002. Kjo shkresë me këto të dhëna ju është dërguar e skanuar me emailin tim privat ***. por nuk pasqyrohet në raportin tuaj të rezultateve të hetimit administrativ [...]”.* Këtë pretendim, subjekti i rivlerësimit e ka ngritur edhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore të datës 24.12.2020.

33.8. Trupi gjykues vëren se gjatë hetimit administrativ subjekti nuk ka depozituar dokumentacion nga organet tatimore, i cili të provonte regjistrimin e tij si tatimpagues apo të dhëna të tjera lidhur me qarkullimin/fitimin e realizuar nga aktiviteti tregtar si person fizik, fakt i cili konfirmohet nga verifikimi i gjithë korrespondencës elektronike midis Komisionit dhe subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, nga verifikimi i dokumentacionit shoqërues të deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”, nuk rezulton që subjekti të ketë depozituar dokumentacion justifikues ligjor, vërtetime nga organet tatimore, për të provuar të ardhurat e deklaruara prej tij nga aktiviteti si avokat.

33.9. Për sa më sipër, nuk qëndron pretendimi i subjektit i parashtruar gjatë prapësimeve dhe seancës dëgjimore se Komisioni nuk ka marrë për bazë dokumentacionin e depozituar prej tij gjatë hetimit administrativ, e konkretisht 2 shkresa të DRT-së Vlorë, të cilat referonin të dhëna për aktivitetin tregtar të zhvilluar nga subjekti “Pelivan Malaj”, si person fizik. Vlen të theksohet këtu se, në vlerësimin e trupit gjykues, subjekti nuk është treguar bashkëpunues gjatë gjithë procesit të rivlerësimit të kryer ndaj tij.

34. Në këtë kuptim, bazuar në dokumentacionin e administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, e konkretisht shkresave të Drejtorisë së Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë si edhe shkresave pjesë e dosjes së hetimit të kryer nga ILDKPKI, të cilat nuk konfirmonin të dhëna të regjistrimit në organin tatimor të subjektit të rivlerësimit, z. Pelivan Malaj, në analizën financiare, zëri i të ardhurave nga aktiviteti tregtar si person fizik (avokat) është shënuar me vlerë 0 (zero), duke i kaluar subjektit barrën e provës me dërgimin e rezultateve të hetimit.

34.1. Megjithëse në prapësimet e tij subjekti i rivlerësimit referon 2 shkresa të Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë, për të cilat pretendon se janë paraqitur prej tij gjatë hetimit administrativ, nga verifikimi i fizik i dokumentacionit të depozituar në Komision, bashkëlidhur gjendet vetëm shkresa e DRT-së Vlorë me nr. *** prot., datë 4.2.2020, me lëndë “Kthim përgjigjeje”, drejtuar subjektit të rivlerësimit.

34.2. Pas verifikimit të provave të reja të depozituara nga subjekti i rivlerësimit me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit (ku evidentohen edhe shkresa të tjera të DRT-së dhe Bashkisë Vlorë, të cilat nuk referohen nga subjekti në prapësimet e tij) dhe analizimit dhe vlerësimit të tyre në harmoni me provat e depozitura më parë në ILDKPKI, si edhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioni, bazuar në metoda alternative kreu përlllogaritjen (me rezervë) të qarkullimit të realizuar nga aktiviteti tregtar i personit fizik “Pelivan Malaj”, për periudhën 1994 – 2002.

34.3. Ligji i zbatueshëm

Ligji nr. 7679, datë 3.3.1993 “Për tatimin mbi biznesin e vogël” (aktualisht i shfuqizuar);
Ligji nr. 8313, datë 26.3.1998 “Për tatimin mbi biznesin e vogël” (aktualisht i shfuqizuar);
Pika 2 e nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

34.4. Dokumentacioni mbi bazën e të cilit është kryer analiza

A. Dokumentacioni i depozituar nga subjekti në ILDKPKI me dorëzimin e deklaratës “Vetting” (i paraqitur fotokopje) si vijon:²²

- i. vendim i datës 24.4.1993 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për regjistrimin si subjekt juridik privat për zhvillimin e veprimtarisë private në fushën e avokatisë;
- ii. leje për ushtimin e profesionit të avokatit, lëshuar në datën 13.4.1993 nga Këshilli Mbikëqyrës i Avokatisë;
- iii. licencën e avokatit, lëshuar më 28.12.2000;
- iv. leje për ushtrim aktiviteti për periudhën janar 1996 deri në datën 31.12.1996 me objekt kryesor të veprimtarisë “Avokat dhe fotokopje”, lëshuar nga Dega e Tatim Taksave Vlorë;
- v. certifikatë regjistrimi në organin tatimor nr. serial ***, për ushtrimin e aktivitetit si person fizik me dy kode fiskale (**dhe **), por pa të dhëna identifikuese të subjektit;
- vi. fletënjoftim tatimi me nr. regjistrimi ***, datë 1.1.1994 (profesioni avokat), për periudhën 1.1.1994 - 31.12.1994;
- vii. fletënjoftim tatimi me nr. *** regjistrimi, datë 8.4.1994 (fotokopje), duke filluar nga tremujori i dytë llogaritja e tatimit;
- viii. fletënjoftim tatimi (pa numër regjistrimi) për periudhën 1.1.1995 - 31.12.1995 (profesioni avokat);
- ix. fletënjoftim tatimi (pa numër regjistrimi) për periudhën 1.1.1995 - 31.12.1995 (profesioni fotokopje);
- x. letënjoftim tatimi me nr. *** dhe *** regjistrimi, datë 2.3.1996 (për profesionin avokat dhe fotokopje);
- xi. fletënjoftim me nr. *** dhe *** regjistrimi, datë 29.1.1997, (për profesionin avokat dhe fotokopje) për periudhën 1.1.1997 - 31.12.1997;
- xii. mandatar-këtimi për pagesë sigurimesh shoqërore, me nr. ***, datë 15.3.1996;
- xiii. mandatar-këtimi për pagesë sigurimesh shoqërore, me nr. ***, datë 14.6.1996;
- xiv. mandatar-këtimi për pagesë sigurimesh shoqërore, datë 16.9.1996;
- xv. mandatar-këtimi për pagesë sigurimesh shoqërore, me nr. ***, datë 31.12.1996;
- xvi. mandatar-këtimi për pagesë tatim taksash, nr. ***, viti 1996;
- xvii. mandatar-këtimi për pagesë tatim taksash, nr. ***, viti 1996;
- xviii. mandatar-këtimi për pagesë tatim taksash, nr. ***, viti 1996;
- xix. mandatar-këtimi për pagesë tatim taksash, nr. ***, viti 1996;
- xx. librezë pune;

B. Dokumentacioni pjesë e dosjes së hetimit të kryer nga ILDKPKI:

- i. Shkresa e QKB-së me nr. *** prot., datë 24.7.2017;
- ii. Shkresa e DPT-së me nr. *** prot., datë 26.7.2017;
- iii. Shkresa e DPT-së me nr. ***prot., datë 26.7.2017;
- iv. Shkresa e DRT-së Vlorë me nr. *** prot., datë 11.7.2017;
- v. Shkresa e Bashkisë Vlorë me nr. ***prot., datë 14.7.2017;
- vi. Shkresa e ISSH-së me nr. ***prot., datë 12.7.2017.

C. Dokumentacioni i administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ:

- i. Shkresa e ISSH-së me nr. *** prot., datë 6.2.2019;
- ii. Shkresa e DRSSH-së Vlorë me nr. *** prot., datë 28.1.2020;
- iii. Shkresa e QKB-së me nr. *** prot., datë 19.2.2019;

²² Dokumentacioni pjesë e dosjes së ILDKPKI-së – aneksi ***.

- iv. Shkresa e DPT-së me nr. *** prot., datë 6.2.2019;
- v. Shkresa e DRT-së Vlorë me nr. *** prot., datë 24.1.2020.

D. Dokumentacion tjetër (krahas atij të depozituar në ILDKPKI) depozituar nga subjekti gjatë hetimit administrativ dhe me dërgimin e prapësimeve:

- i. Shkresa e DRT-së Vlorë me nr. *** prot., datë 17.12.2020;
- ii. Shkresa e DRT-së Vlorë me nr. *** prot., datë 14.12.2020;
- iii. Shkresa e DRT-së Vlorë me nr. *** prot., datë 4.2.2020;
- iv. Shkresa e DRT-së Vlorë me nr. *** prot., datë 18.12.2020;
- v. Shkresa e DTTV-së Bashkia Vlorë me nr. *** prot., datë 4.5.2020;
- vi. Shkresa e DTTV-së Bashkia Vlorë me nr. *** prot., datë 11.12.2020;
- vii. Shkresa e DTTV-së Bashkia Vlorë me nr. *** prot., datë 18.12.2020;
- viii. Disa vendime gjyqësore ku subjekti i rivlerësimit duket se ka qenë në rolin e mbrojtësit ligjor (avokat) dhe kontrata të pretenduara si të përpiluara prej subjektit gjatë kohës që ka ushtruar funksionin e avokatit.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

35. Bazuar në vërtetimet e DRT-së Vlorë, të depozituara nga subjekti nëpërmjet prapësimeve të dërguara pas rezultateve të hetimit (si prova të reja), subjekti Pelivan Malaj ka qenë i regjistruar në DRT-në Vlorë, me kod fiskal ***, me aktivitet avokat, me datë licence 1.1.1994. Gjithashtu, DRT-ja Vlorë informon se, për vitet 1994 – 19997 nuk paraqiten të dhëna, pasi sistemi i kontabilitetit fillon në vitin 1998. Ndërsa, për vitet 1998 – 2002 nga ky subjekt janë kryer pagesat e tatimit mbi biznesin e vogël si vijon:

Tabela nr. 2

Nr.	Data e pagesës	Vlera e paguar/lekë	Lloji i tatimit
1.	11.3.1998	12,666	Tatim biz.vogël profesione të lira
2.	21.10.1999	8,750	Tatim biz.vogël profesione të lira
3.	30.11.2000	48,750	Tatim biz.vogël profesione të lira
4.	31.1.2001	40,000	Tatim biz.vogël profesione të lira
5.	26.2.2001	20,000	Tatim biz.vogël profesione të lira
6.	26.2.2001	40,000	Tatim biz.vogël profesione të lira
7.	21.12.2001	30,000	Tatim biz.vogël profesione të lira
8.	18.4.2002	35,000	Tatim biz.vogël
9.	28.6.2002	35,000	Tatim biz.vogël
10.	17.5.2002	12,000	Taksë solidariteti biz.vogël
11.	28.6.2002	6,000	Taksë solidariteti biz.vogël

35.1. Ndërsa, bazuar në përgjigjet e kthyer nga Bashkia Vlorë (Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore), referohet se për vitet 1993 – 2003 nuk ka regjistra të asnjë tatimpaguesi pranë kësaj drejtorie.

35.2. Nga vlerësimi i provave të depozituara me prapësimet pas dërgimit të rezultateve të hetimit, duket se subjekti ka bërë përpjekje për të siguruar dokumentacion për të provuar të ardhurat e realizuara prej tij përgjatë gjithë periudhës që ka kryer aktivitet tregtar, si edhe në vitet 1994 – 1997. Në këtë këndvështrim, në kuptim të pikës 2 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 duket se subjekti është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentacion që justifikon ligjshmërinë e të ardhurave për këtë periudhë (vitet 1994 – 1997).

35.3. Nga vlerësimi në harmoni i të dhënave të mësipërme me provat/indiciet e tjera të depozituara nga subjekti, si edhe bazuar në legjislacionin në fuqi, Komisioni rezervoi të

drejtën të përllogarisë në mënyrë alternative të ardhurat/qarkullimin e mundshëm (me rezervë) të realizuar nga subjekti tregtar “Pelivan Malaj”, person fizik, për këtë periudhë (vitet 1994 – 1997). Nga analizimi i fletënjoftimeve tatimore dhe mandatpagesave (të cilat referojnë të dhëna për pagesa të kryera për vitin 1996) duket se subjekti i rivlerësimit, për periudhën 1994 – 1997 ka ushtruar aktivitet i pajisur me dy kode fiskale, për avokat dhe fotokopje.

35.4. Bazuar në pikën “c” të nenit 3 të ligjit nr. 7679, datë 3.3.1993 “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, avokatët tatheshin në masën 8% si tarifë proporcionale mbi të ardhurat, ndërsa, për aktivitetin e fotokopjes vlerësohet se do kategorizohet në aktivitetet e parashikuara në pikën “g” të nenit 3 të këtij ligji (*..çdo aktivitet tjetër i pavarur fitimprurës që ushtrohet në dyqane ose në njësitë e tjera të veçanta...*), i cili tathohet në masën 5% si tarifë proporcionale mbi të ardhurat. Nga verifikimi i fletënjoftimeve tatimore për vitin 1996 (për aktivitetin avokat dhe fotokopje), duket se tatimi i parashikuar në këto dokumente përputhet me tatimin e paguar sipas mandatpagesave të depozituara nga subjekti.

35.5. Në këtë kuptim, trupi gjykues vlerësoi që qarkullimi për këto vite të përllogaritet bazuar në masën e tatimit të parashikuar në fletënjoftimet tatimore, në raport me legjislacionin në fuqi, i cili referon përqindjen e tatimit që duhej paguar mbi qarkullimin (të ardhurat). Për vitin 1997, duke konsideruar faktin se bazuar në shkresën e DRSSH-së Vlorë subjekti ka derdhur kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore vetëm për 3 muaj, qarkullimi do llogaritet për 3 muaj aktivitet.

35.6. Bazuar në të dhënat e mësipërme, Komisioni përllogariti qarkullimin e realizuar nga aktiviteti tregtar i kryer nga subjekti tregtar “Pelivan Malaj”, për periudhën 1994 – 1997, pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 3

Periudha/vitet	1994	1995	1996	janar - mars 1997
Fletënjoftim tatimor 8% e qarkullimit si avokat/lekë	14,000	12,000	12,000	27,500
Fletënjoftim tatimor 5% e qarkullimit si fotokopje/lekë	6,500	9,000	9,000	7,500
Qarkullimi në proporcion me pagesat e detyrimeve tatimore/lekë	305,000	330,000	330,000	493,750

35.7. Sa më sipër, duket se qarkullimi i realizuar (me rezervë) nga aktiviteti tregtar i përllogaritur për këtë periudhë është në vlerën 1,458,750 lekë.

35.8. Bazuar në pikën 2 të nenit 3 (ndarja e qyteteve sipas kategorive) si edhe germës “dh” të nenit 3 të ligjit nr. 8313, datë 26.3.1998 “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, subjektet të cilat ushtronin aktivitetin e avokatit në qytetin e Vlorës për qarkullimin deri në 2 milion lekë kanë pasur detyrimin për pagesën e tatimit në kuotë fikse në shumën 70,000 lekë në vit. Për periudhën 1998 - 2002 nuk kemi të dhëna që subjekti të ketë ushtruar aktivitetin e fotokopjes.

35.9. Ndërsa referuar nenit 5 të ligjit të sipërcituar për subjektet që realizojnë qarkullim në shumën nga 2 deri në 5 milion lekë, tatimi që kanë pasur detyrim për këtë fashë xhiroje është në masën 4% të qarkullimit. Në pikën 4 të nenit 8 të ligjit nr. 8313, datë 26.3.1998 “Për tatimin mbi biznesin e vogël” përcaktohet se tatimi mbi xhiron 4% paguhet vetëm një herë në vit, deri më 25 dhjetor të atij viti.

Bazuar në informacion e pasqyruar në shkresat e DRT-së Vlorë, të referuara më sipër, Komisioni përlllogaritë qarkullimin e realizuar nga aktiviteti tregtar i kryer nga subjekti i rivlerësimit për periudhën 1998 – 2002, pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 4

Periudha/vitet	1.1.1998- 28.2.1998	15.10.1999- 31.12.1999	2000	2001	2002
DRT-ja Vlorë, pagesat e kryera, (i) 0-2 milion 70,000 lekë dhe (ii) mbi 2 milion 4% e qarkullimit.	12,666	8,750	48,750	130,000	70,000
Qarkullimi në proporcion me pagesat e detyrimeve tatimore/lekë	361,886	250,000	1,392,857	3,500,000	2,000,000

36. Sa më sipër, duket se qarkullimi i realizuar nga subjekti tregtar “Pelivan Malaj”, person fizik i përlllogaritur për periudhën 1998 - 2002, është në vlerën 7,504,703 lekë.

Pra, duket se në total qarkullimi i realizuar (i përlllogaritur me rezervë) nga aktiviteti tregtar për periudhën 1994 – 2002, është në shumën 8,963,493 lekë.

Lidhur me përlllogaritjen e marzhit të fitimit neto, nisur nga lloji i aktivitetit të kryer dhe në mungesë të informacionit për shpenzime të tjera të kryera nga subjekti, krahas shpenzimeve për pagesën e detyrimeve tatimore, taksave vendore dhe kontributeve për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, trupi gjykues vlerësoi të përlllogaritet në masën 80% të qarkullimit.

37. Pasuri të tjera të pasqyruara si të krijuara deri në shtator të vitit 1999

37.1. Konstatohet se në deklaratën “Vetting”, subjekti ka deklaruar pasurinë e llojit “njësi shërbimi”, zyrë avokatie²³, me sipërfaqe 20 m², ndërtuar në vitin 1996, vlera e ndërtimit 700,000 lekë, me burim krijimi të ardhurat nga avokatia dhe e legalizuar. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se më 17.10.2016 kjo pasuri është shpronësuar me VKM-në nr. 595, datë 31.8.2016 dhe vlera e shpronësimit është 1,247,400 lekë.

37.2. Deklarimi i kësaj pasurie në vite: Siç u pasqyrua më sipër, në deklarinimin fillestar të pasurisë subjekti ka deklaruar pasurinë në bashkëpronësi me bashkëshorten, zyrë avokatie me sipërfaqe 20 m², ndërtuar në vitin 1996, me vlerë 2,000,000 lekë, ndodhur në lagjen “****”, përballë Gjykatës së Rrethit Vlorë. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar të ardhurat nga profesioni i avokatit. Ndërsa, në DPV/2013, në rubrikën “ndryshimi i pasurive, shtesa/pakësime” subjekti i rivlerësimit ka deklaruar zyrë avokatie, e ndodhur në qytetin e Vlorës, me sipërfaqe 21 m², me vlerë 3 milion lekë, përfituar nga legalizimi.

37.3. Konkluzioni i ILDKPKI-së për këtë pasuri: mungesë dokumentacion justifikues ligjor për shumën e shpenzuar për zyrën e avokatisë. Sipas deklaratës së rivlerësimit vlera e ndërtimit është 700,000 lekë, ndërsa në deklaratën fillestare të pasurisë është deklaruar

²³ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI): - (i) Certifikatë për vërtetim pronësie nr. *** për truall me sip. 21 m², nga sa ndërtesa me sip. 21 m², me nr. *** pasurie, zona kadastrale ***, vol. ***, fq. ***, lëshuar në datën 28.8.2013; (ii) kartelë e kalimit të pronësisë së sipërfaqes ndërtimore nr. ***, datë 3.2.2012, për sipërfaqen 21 m², për pasurinë me nr. ***, zona kadastrale *** + genplan; dhe (iii) njoftim për shpronësimin publik nr. *** prot., datë 3.8.2016.

2,000,000 lekë. Nga dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti për këtë pasuri (pjesë e dosjes së ILDKPKI-së, aneksi ***) konstatohet se:

- i. me kontratën e kalimit të pronësisë²⁴ të datës 3.2.2012 (në bazë të VKM-së nr. 359, datë 4.5.2011) të lidhur me Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Vlorë, është kaluar në emër të subjektit të rivlerësimit pronësia e parcelës ndërtimore me sipërfaqe 21 m², me nr. *** pasurie, të ndodhur në zonën kadastrale ***;
- ii. në datën 28.8.2013, në emër të subjektit është lëshuar certifikata e pronësisë²⁵ për pasurinë e llojit “truall”, me sipërfaqe 21 m², nga kjo sipërfaqe e ndërtesës 21 m² (nr. pasurisë ***, volum ***, faqe ***, zona kadastrale ***);
- iii. në datën 3.8.2016, subjekti i rivlerësimit është njoftuar nga Drejtoria e Legjislacionit në Ministrinë e Zhvillimit Urban²⁶ për shpronësimin e kësaj pasurie, në vlerën totale 1,247,400 lekë.

37.4. ALUIZNI (Drejtoria e Përgjithshme)²⁷ informon se subjekti i rivlerësimit, z. Pelivan S., Malaj dhe të tjerë, rezulton të jenë pajisur me leje legalizimi nr. ***, datë 28.1.2013, për objektin “godinë banimi një kat”, Vlorë. Komisioni nuk ka arritur të administrojë informacionin e plotë për këtë pasuri të legalizuar, pasi, nuk ka pasur përgjigje as nga Drejtoria e Aluiznit Vlorë, njëkohësisht as nga ZVRPP-ja.

37.5. Pasi Komisioni i kërkoi subjektit të deklarojë periudhën e ndërtimit të këtij objekti, vlerën e ndërtimit dhe burimin e krijimit të saj, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, deklaroi se²⁸ *vlera 700,000 lekë për ndërtimin e zyrës, është vlerë e përafërt e materialeve të ndërtimit të përdorur dhe krahun e punës për punëtorët që kanë punuar. Objekti ishte i përmasave të vogla, me konstruksion blloqe betoni dhe solete me trarë. Ndërtimi është bërë mbi bazën e një lejeje provizore ndërtimi të dhënë nga Bashkia Vlorë për zyrë avokatie, që gjithsesi iu nënshtrua procesit të legalizimit. Deklarimi i vlerës 2,000,000 lekë më 19.3.2004, që i takon periudhës deklaruese të vitit 2003, është një përlllogaritje e vlerës që ky objekt mund të shitej si zyrë avokatie për shkak të pozicionit pranë Gjykatës së Rrethit Vlorë, nisur edhe nga vlera e objekteve të ngjashme që janë shitur në atë kohë, bazuar edhe në indeksimin e çmimeve nga viti 1996 deri në vitin 2003. Deklarimi tjetër është dhjetë vjet më vonë dhe, kuptohet që vlera e këtij objekti - sipas tregut, sepse në shkurt të vitit 2012 objekti është legalizuar dhe regjistruar. Këto vlera janë deklaruar sepse në deklaratën e pasurisë ka qenë detyrim në kollonën përkatëse që duhej vënë patjetër vlera e objektit.*

37.6. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se *nuk ka mbajtur dokumentacion për materialet e ndërtimit të blera, sepse ato i merrnin në tregun e lirë punëtorët që punonin, edhe punimet për këtë objekt të vogël janë kryer me punëtorë të rastësishëm dhe nuk e ka patur detyrim në atë kohë.*

37.7. Subjekti ka depozituar si provë të re për ndërtimin e kësaj pasurie, kopje të lejes së ndërtimit provizore të datës 8.2.1993 të lëshuar nga seksioni i urbanistikës pranë Këshillit të Rrethit Vlorë. Sipas këtij dokumenti, z. Pelivan Malaj i jepet leje për ndërtim provizor të njësisë “zyrë avokatie”, në lagjen “***”, Vlorë. Në këtë leje përcaktohet se objekti do të ndërtohet me materiale të lehta si dërrasë, fibër, llamarinë, etj. Toka mbi të cilën jepet leja për ndërtimin e objektit është në pronësi të shtetit dhe i jepet me qira subjektit, por nuk është përcaktuar afati dhe vlera e qirasë.

²⁴ Kontrata e kalimit të pronësisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.2.2012.

²⁵ Certifikatë për vertetim pronësie nr. ***.

²⁶ Shkresa nr. *** prot., datë 3.8.2016 me lëndë “Njoftim për shpronësim publik”.

²⁷ Shkresa nr. *** prot., datë 12.2.2019.

²⁸ Përgjigje e pyetjes nr. 3 të pyetësorit nr. 2.

37.8. Sa më sipër, Komisioni konstaton se ka mospërputhje në deklaratimet e subjektit lidhur me vlerën e këtij objekti, pasi në deklarinimin fillestar të pasurisë është deklaruar në vlerën 2,000,000 lekë, në DPV/2013 në vlerën 3,000,000 lekë, ndërsa në deklaratën “Vetting” në vlerën 700,000 lekë.

Nëpërmjet prapësimeve pas rezultateve të hetimit subjekti i rivlerësimit u qëndroi shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ lidhur me deklaratimet e vlerave të ndryshme të kësaj pasurie, duke sqaruar, ndër të tjera *se ato janë shënuar prej tij nisur nga vlera e tregut meqenëse kjo vlerë kërkohej në kollonën përkatëse të deklaratës së pasurisë...Vlera 2,000,000 lekë është vendosur meqenëse ende kjo zyrë nuk ishte legalizuar, nuk ishte regjistruar në ZRPP-në Vlorë. Pas legalizimit, nisur nga fakti se kjo gjendje legale e kësaj prone mund t'i rriste vlerën, ka deklaruar si vlerë 3,000,000 lekë. Ndërkohë, që vlera prej 700,000 lekësh e deklaruar në deklaratën “Vetting” përfaqëson paratë që ai ka shpenzuar për ndërtimin e zyrës.*

37.9. Komisioni, pasi vlerësoi me objektivitet dhe paanësi prapësimet e subjektit të rivlerësimit në harmoni me provat e depozituara prej tij gjatë hetimit administrativ dhe pas dërgimit të rezultateve të hetimit, çmon se shpjegimet e tij për vlerën e ndërtimit të këtij objekti prej 700,000 lekësh duken bindëse, duke marrë në konsideratë faktin se ky objekt referuar lejes provizore do të ndërtohej me materiale të lehta dhe se rreth 20 vjet mbas ndërtimit të tij është shpronësuar me vlerën 1,247,400 lekë. Në këtë kuptim, në analizën financiare të kryer nga Komisioni, vlera e këtij objekti është pasqyruar në shumën 700,000 lekë.

38. Si konkluzion, trupi gjykues vlerësoi se pasaktësitë/mospërputhjet në deklarinim lidhur me vlerën e kësaj pasurie janë pa pasoja konkrete dhe, si të tilla, ato nuk kanë prodhuar efekte rënduese gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar.

39. Subjektit iu kërkua të depozitonte dokumentacionin e plotë të paraqitur prej tij në zyrat e Aluiznit Vlorë për legalizimin e kësaj pasurie, si edhe të deklarojë mbi shumën e qirasë së paguar për përdorimin e truallit në pronësi shtetërore, para legalizimit.

Në prapësimet e dërguara në Komision, subjekti pretendoi se prej tij është paraqitur dokumentacioni i plotë për legalizimin dhe regjistrimin e kësaj pasurie në ZRPP si edhe ai i shpronësimit të saj. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se nuk ka patur ndonjë kontratë qiraje për sipërfaqen prej 21 m² që ka pas zënë ky ndërtim dhe se asnjë organ apo institucion nuk i ka vënë në dukje një detyrim të tillë.

40. Komisioni vëren se nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI me dorëzimin e deklaratës “Vetting”, si edhe dokumentacionit të depozituar prej tij gjatë hetimit administrativ dhe me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, nuk rezulton që të jetë paraqitur dokumentacion i plotë për legalizimin dhe regjistrimin e kësaj pasurie në ZVRPP, e konkretisht formulari i vetëdeklarimit të objektit pa leje, me dokumentacionin shoqërues, si edhe leja e legalizimit.

Në këtë këndvështrim, në kushtet kur nuk vërehen përpjekje të subjektit për sigurimin e këtij dokumentacioni, trupi gjykues çmon se subjekti nuk është treguar bashkëpunues në kuptim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

41. Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, vetëdeklarimet e bëra nga subjekti, si edhe vlerësimit të bërë për ligjshmërinë e burimeve të deklaruara për krijimin e pasurisë (njëri nga burimet deklaruar edhe për ndërtimin e zyrës në vitin 1996), Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë, me qëllim verifikimin e mundësisë për kryerjen e pagesës 31,000 dollarë deri në shtator të vitit 1999 (pagesa e fundit në 20.9.1999), paguar si çmim për

blerjen e apartamentit prej 120 m², të ndodhur në lagjen “****”, Vlorë, si edhe për kryerjen e shpenzimeve për ndërtimin e zyrës së avokatisë, pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 5. Analiza financiare - periudha deri në shtator 1999

Përshkrimi	Vlera në lekë
Të ardhurat neto nga pagat e subjektit, mars 1998 – 15 tetor 1999	760,414
Të ardhurat neto të bashkëshortes, të dokumentuara	499,230
Të ardhura nga avokatia/fotokopje subjekti (80% e qarkullimit) 1994-1998	1,456,508
Të ardhura nga shitja e apartamentit në Vlorë në datën 27.10.1999, sipas kontratës	0
Total të ardhura/të hyra financiare	2,716,153
Shpenzime mobilimi 1996-1999, deklaruar në pyetësor	150,000
Shpenzime minimale për konsum sipas standardit të KPA-së, për periudhën janar 1994 - shtator 1999	1,380,000
Total shpenzime/të dala financiare	1,530,000
Mjete monetare të disponueshme (1)	1,186,153
Pagesa për blerje ap. banimi në Vlorë viti 1993 ²⁹	5,134
Pagesa për blerje ap. banimi me sip. 120 m ² Vlorë, shtator viti 1999	4,406,080
Pagesa për ndërtimin së avokatisë (ndërtuar në vitin 1996) sipas deklaratës “Vetting”	700,000
Detyrime	0
Pasuri neto (2)	5,111,214
Balanca e fondeve (1-2)	- 3,925,061

Sa më sipër, Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka patur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht pagesën e kryer deri në shtator 1999, në vlerën 31,000 dollarë, për blerjen e apartamentit në Vlorë apo shpenzimet e kryera për ndërtimin e zyrës së avokatisë në vlerën 700,000 lekë.

42. Trupi gjykues çmon se, edhe nëse merren të mirëqena pretendimet e subjektit se të ardhurat nga shitja e apartamentit të përfituar më parë nga privatizimi janë marrë paradhënie prej tij, duke mbajtur parasysh çmimin e përcaktuar në kontratën e shitjes, si edhe faktin se nuk u provua pagesa e detyrimeve tatimore për të ardhurat shtesë, të pretenduara si të përfituara nga kjo shitje e realizuar³⁰, sërish subjekti do të rezultonte me pamundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie në vlerën 31,000 dollarë.

43. Komisioni konstatoi se në deklaratën fillestare të pasurisë, krahas pasurive të analizuara si më sipër, subjekti dhe personat e lidhur kanë deklaruar edhe pasuritë si më poshtë vijon:

- i. autoveturë në bashkëpronësi me bashkëshorten, e markës “Volkswagen”, me targë VL***, me vlerë 400,000 lekë, blerë në vitin 2000, me burim krijimi të ardhurat nga avokatia;

²⁹ Në tabelën e analizës financiare kjo e dhënë është përfshirë me qëllim pasqyrimin e momentit të pagesës së kryer për privatizimin e banesës dhe jo për qëllim të pasqyrimin të shpenzimit të kryer, pasi, nisur nga vlera e vogël, duket se nuk ndikon në analizën financiare. Përlllogaritja e të ardhurave dhe shpenzimeve është kryer nga viti 1994 e në vijim, në mungesë të evidencave të sakta për të ardhurat e subjektit para vitit 1994.

³⁰ Nuk u dokumentua pagesa e detyrimeve tatimore për shumën e të ardhurave 800,000 lekë, të ardhura shtesë të pretenduara si të përfituara dhe që i përkasin diferencës midis çmimit të deklaruar nga subjekti në vlerën 2,700,000 lekë dhe çmimit të përcaktuar në kontratë në vlerën 1,900,000 lekë.

- ii. autoveturë, në bashkëpronësi me bashkëshorten, e markës “Renault Twingo”, me targë VL***, me vlerë 600,000 lekë, blerë në vitin 2003 me të ardhurat nga avokatia;
- iii. shumën 450,000 lekë, depozitë në emër të bashkëshortes në Bankën e Kursimeve, me burim krijimi të ardhurat nga profesioni i avokatit;
- iv. shumën prej 50,000 lekë, gjendje llogari në emrin e tij në Bankën e Kursimeve, me burim krijimi të ardhurat nga ushtrimi i profesionit i avokatit;
- v. gjendje *cash*, shumën 1,000,000 lekë, me burim krijimi të ardhurat nga ushtrimi i profesionit të avokatit; dhe
- vi. huadhënie në shumën 1,000,000 lekë, shumë kjo e dhënë vëllezërve dhe kunatës. Si burim krijimi subjekti ka deklaruar të ardhurat nga ushtrimi i profesionit të avokatit dhe të ardhura të pakta nga paga.

44. Automjetet / pasuri gjendje deklaruar deri në datën 31.12.2003

44.1. Sipas informacionit nga DPSHTRR-ja rezulton se në datën 14.2.2003 subjekti i rivlerësimit ka blerë automjetin e markës “Renault”, tip “Twingo”, vit prodhimi 1993, me targë MO***, për vlerën 200,000 lekë.

Për këtë mjet janë paguar nga subjekti detyrimet e zhdoganimit në vlerën 148,000 lekë dhe janë kryer procedurat e regjistrimit të tij. Në analizën paraprake financiare të kryer nga Komisioni, vlera e këtij mjeti është pasqyruar në shumën 600,000 lekë, vlerë e vetëdeklaruar nga subjekti i rivlerësimit.

44.2. Me prapësimet e dërguara pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar, ndër të tjera *se kjo pasuri, pavarësisht deklarimit të tij të pasaktë, rezulton të jetë blerë 200,000 lekë, sipas kontratës së shitblerjes, duke i shtuar këtu edhe vlerën e zhdoganimit 148,000 lekë, por kurrësi nuk mund të jetë 600,000 lekë.*

Si konkluzion, duke vlerësuar shpjegimet e dhëna nga subjekti si më sipër, si dhe duke konsideruar si provë aktin e shitblerjes dhe deklaratën doganore, në përputhje me qëndrimin dhe qasjen e vazhdueshme të mbajtur nga Komisioni, si vlerë e këtij automjeti në analizën financiare do reflektohet vlera e shënuar si çmim për blerjen e tij dhe shuma e shpenzuar për detyrimet doganore.

44.3. Ndërsa, për automjetin e markës “Volkswagen”, Komisioni vëren se nuk janë dërguar të dhëna nga DPSHTRR-ja, gjithsesi, në përgjigje të pyetësorit nr. 2³¹, subjekti ka rikonfirmuar se kjo pasuri, është blerë prej tij në shumën 400,000 lekë dhe është nxjerrë jashtë përdorimit në vitin 2004.

44.4. Në mungesë të dokumentacionit ligjor, por bazuar në deklaratimet e subjektit, në analizën financiare do të reflektohet shuma 400,000 lekë si vlerë e shpenzuar nga subjekti për blerjen e këtij mjeti. Në prapësimet e tij subjekti ka pretenduar se *deklarimi me vlerë 400,000 lekë ka qenë lapsus dhe se ai e ka blerë këtë mjet për shumën 40,000 lekë.*

Bazuar në të dhënat si më sipër, Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit mbeten të karakterit deklarativ, për rrjedhojë, në analizën financiare do pasqyrohet si vlerë blerjeje e këtij automjeti shuma 400,000 lekë.

45. Gjendja e likuiditeteve deklaruar deri në datën 31.12.2003

45.1. Siç u pasqyrua më sipër, në deklaratën fillestare të pasurisë subjekti ka deklaruar: (i) vlerën totale 500,000 lekë gjendje në llogari bankare (rrjedhëse/depozitë) në emër të tij dhe

³¹ Referohu përgjigjes së pyetjes nr. 8.

bashkëshortes; (ii) vlerën totale 1,000,000 lekë si gjendje *cash*; dhe (iii) vlerën 1,000,000 lekë dhënë hua të afërmve të tij.

Pra, rezulton se gjendja e likuiditeteve të krijuara nga subjekti i rivlerësimit deri në datën 31.12.2003 është në vlerën prej 2,500,000 lekësh (likuiditet në bankë, *cash* dhe të dhëna hua – të pritshme).

45.2. Bazuar në të dhënat e vetëdeklaruar/provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit, informacionin/dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, si edhe në analizën e kryer për të ardhurat e përfituara nga aktiviteti tregtar i subjektit të rivlerësimit, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë për periudhën deri në datën 31.12.2003, të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 6. Analiza financiare - periudha deri më 31.12.2003

Përshkrimi	Vlera në lekë
Të ardhurat neto nga pagat e subjektit, për periudhën	1,318,658
Të ardhurat neto të bashkëshortes, të dokumentuara	499,230
Të ardhura nga avokatia/fotokopje subjekti (80% e qarkullimit) 1994 - 2002	7,170,794
Të ardhura nga shitja e apartamentit në Vlorë në datën 27.10.1999, referuar kontratës	1,900,000
Total të ardhura/të hyra financiare	10,388,682
Shpenzime mobilimi 1996-1999, deklaruar në pyetësor	150,000
Shpenzime minimale për konsum sipas KPA-së, për periudhën 1994 - 1999 ³²	1,380,000
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT-it, ILDKPKI-së, për periudhën 2000 - 2003	887,184
Total shpenzime/të dala financiare	2,417,184
Ndryshim mj.monetare cash, gj.fillim - gj.fund periudhe deklaruar	-1,000,000
Ndryshim mj.monetare banke, gj.fillim - gj.fund periudhe deklaruar	-500,000
Mjete monetare të disponueshme (1)	6,971,498
Vlera monetare huadhënie deklaruar në deklarinimin për herë të parë	1,000,000
Pagesa për blerje ap. banimi në Vlorë, viti 1993 (apartamenti i përfituar nga privatizimi)	5,134
Pagesa për blerje ap. banimi me sip. 120 m ² në Vlorë, viti 1999	4,406,080
Pagesa për shpenzime për ndërtimin e zyrës së avokatisë (ndërtuar në vitin 1996)	700,000
Pagesa për blerje autoveturë “VW, Golf 2” me targë TR***, blerë në vitin 2000	400,000
Pagesa për blerje autoveturë “Renault Twingo” me targë VL***, blerë në vitin 2003 ³³	348,000
Detyrime	0
Pasuri neto (2)	6,859,214
Balanca e fondeve (1-2)	112,284

45.3. Sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar blerjen e dy automjeteve dhe krijimin e gjendjeve të likuiditeteve (cash + bankë + të dhëna hua), pasuri gjendje në datën 31.12.2003.

45.4. Vlen të theksohet se, megjithëse në këtë tabelë për efekt analize janë përfshirë edhe pasuritë e paluajtshme, apartamenti prej 120 m² dhe zyra prej 21 m², të ndodhura në Vlorë,

³² Në ndryshim nga analiza e paraqitur në rezultatet e hetimit, shpenzimet jetike janë përllogaritur prej vitit 1994.

³³ Në ndryshim nga analiza e paraqitur në rezultatet e hetimit, vlera e automjetit “Renault” është përllogaritur sipas vlerës së përcaktuar në kontratë + shpenzime zhdoganimi.

rezultati pozitiv i saj nuk lidhet me këto dy pasuri, pasi, në përputhje me analizën financiare të kryer më sipër (deri në shtator të vitit 1999) rezultoi subjekti i rivlerësimit nuk ka patur burime financiare të ligjshme për krijimin e tyre³⁴.

46. Pasuria e llojit “automjet”, e markës “Mercedes-Benz³⁵, blerë në datën 14.12.2015

46.1. Si burim krijimi të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar të ardhurat nga shitja në datën 21.12.2015 të automjetit të markës “Renault”, tipi “Clio”, në vlerën 2,000 euro, duke sqaruar se ky automjet është shitur dhjetë ditë para nënshkrimit të kontratës, duke u marrë paradhënie shuma 2,000 euro.

46.2. Deklarimi i kësaj pasurie në vite: nga verifikimi i DPV/2015 konstatohet se subjekti nuk e ka deklaruar këtë pasuri në rubrikën përkatëse, por në rubrikën e të dhënave konfidenciale është deklaruar blerja e mjetit me të dhënat e mësipërme dhe në datën 21.12.2015 është deklaruar shitja e automjetit “Renault Clio”, në shumën 2,000 euro.

46.3. Konkluzioni i ILDKPKI-së për këtë pasuri: përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjen e ardhur nga DPSHTRR-ja.

Hetimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri

47. DPSHTRR-ja³⁶, konfirmon se në emër të subjektit të rivlerësimit figuron i regjistruar automjeti i markës “Mercedes-Benz” (Daimler Chrysler), tipi “C 220 CDI”, vit prodhimi 2001, me targë AA***. Nga verifikimi i dosjes së këtij mjeti konfirmohet se në datën 14.12.2015 subjekti i rivlerësimit e ka blerë³⁷ këtë automjet, për vlerën 2,000 euro, të zhdoganuar, por të patarguar (me targa EN ***). Në vijim, janë kryer procedurat e regjistrimit dhe ky automjet ka marrë targën AA***.

Verifikimi i kryer nga Komisioni për automjetin “Renault Clio”, të ardhurat nga shitja e të cilit janë deklaruar si burim krijimi i pasurisë objekt vlerësimi

48. Deklarimi i kësaj pasurie në vite: referuar DPV/2014 konstatohet se në rubrikën “ndryshimi i pasurive – shtesa/pakësime”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kontratë shitjeje³⁸ të datës 11.3.2014, për këtë automjet, automjetin “Renault Clio”, për vlerën 2,000 euro, por pa specifikuar që është shtesë pasurie dhe pa deklaruar burimin e krijimit.

48.1. DPSHTRR-ja³⁹, informon se subjekti i rivlerësimit ka patur të regjistruar në emrin e tij automjetin e markës “Renault”, por, nga verifikimi i dosjes së këtij mjeti konstatohet se nuk është dërguar kontrata e plotë e blerjes së tij.

48.2. Rezulton nga kontrata e noterit publik I.B.⁴⁰, se subjekti⁴¹ ka blerë këtë mjet më 11.3.2014, në shumën 2,000 euro, ndërsa, sipas kontratës së datës 21.12.2015, konfirmohet se

³⁴ Referohu analizës financiare të pasqyruar në tabelën nr. 5 të këtij vendimi.

³⁵ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së): (i) kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 14.12.2015; (ii) kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 21.12.2015.

³⁶ Shkresat: (i) nr. *** prot., datë 6.12.2019; dhe (ii) nr. *** prot., datë 7.2.2019.

³⁷ Kontratë shitblerjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.12.2015.

³⁸ Kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.3.2014.

³⁹ Shkresat: (i) nr. ***prot., datë 6.12.2019; dhe (ii) nr. ***prot., datë 7.2.2019.

⁴⁰ Shkresa e datës 15.11.2020, protokolluar në Komision me nr. ***prot., datë 19.11.2020.

⁴¹ Kontrata nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.3.2014.

subjekti i rivlerësimit e ka shitur⁴² këtë automjet për të njëjtën vlerë. Në këtë kontratë, ndër të tjera, përcaktohet se *palët deklarojnë se likuidimin e çmimit të kësaj pasurie e kanë realizuar mes tyre tërësisht jashtë zyrës noteriale, në formën e paradhënies.*

48.3. Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti ka deklaruar saktë të dhënat e pasurisë së llojit “automjet” të markës “Mercedes-Benz”, aktualisht në pronësi të tij. Gjithashtu, nisur nga parashikimet e bëra në kontratën e shitjes së automjetit “Renault Clio”, deklaratimet e bëra në ILDKPKI dhe periudhës së afërt të kryerjes së transaksioneve, duken bindëse shpjegimet e subjektit se të ardhurat nga shitja e kësaj pasurie janë marrë paradhënie dhe se kanë shërbyer si burim krijimi i pasurisë objekt vlerësimi.

49. Pasuria e llojit “automjet” e markës “Jaguar”⁴³, me targa AA*, blerë në datë 16.10.2013, në emër të djalit, E.M., në vlerën 6,500 euro. Subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie.**

49.1 Deklarimi i kësaj pasurie në vite: nga verifikimi i DPV/2013, konstatohet se personi i lidhur, djali i subjektit, E.M., ka deklaruar se disponon veçmas të regjistruar në emrin e tij një autoveturë, por deklarata e tij (pjesë e dosjes së dërguar nga ILDKPKI) është e përbërë vetëm nga një fletë dhe nuk pasqyrohen të dhëna lidhur me këtë pasuri dhe as burimi i krijimit. Ndërsa, nga verifikimi i DPV/2014 konstatohet se subjekti ka deklaruar blerjen e pasurisë automjet të markës “Jaguar” nga djali i tij, E.M., për vlerën 5,500 euro, por nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie.

49.2. Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri: pasaktësi në deklaratën e interesave privatë, lidhur me çmimin e blerjes së automjetit të markës “Jaguar”, në emër të djalit E.M., deklaruar 5,500 dhe jo 6,500 euro.

Hetimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri

50. DPSHTRR-ja⁴⁴, konfirmon se në emër të personit të lidhur, E.M., është i regjistruar automjeti i mësipërm dhe se me kërkesë të tij është nga qarkullimi përkohësisht, nga data 21.6.2019 deri në datën e rifutjes në qarkullim.

I pyetur nga Komisioni për këtë automjet, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se⁴⁵ *në lidhje me blerjen nga djali i tij, E. M., të autoveturës tip “Jaguar”, në tetor të vitit 2013, me të ardhurat e tij si avokat, ai është vënë në dijeni nga djali për këtë blerje, pasi kishte mbushur deklaratën për vitin 2013 në mars të vitit 2014, bile nuk ka patur në dispozicion as kontratën e shitjes së këtij automjeti, e cila për saktësi ka të shënuar si çmim të blerjes atë prej 6,500 eurosh. Deklarimi me gojë që i ka njoftuar djali, i cili në këtë kohë banonte dhe punonte në Tiranë, për vlerën e blerjes ka qenë për 5,500 euro, dhe kjo shifër është vënë në DP të periudhës së vitit 2014. Për këtë shkak, në deklaratën e këtij viti nuk ka shënuar as numrin dhe as datën e kontratës, sepse nuk e dispononte.*

Analiza e të ardhurave të deklaruara si burim për krijimin e kësaj pasurie

⁴² Kontratë shitblerjeje autoveture nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.12.2015.

⁴³ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së): (i) kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 16.10.2013.

⁴⁴ Shkresa nr. *** prot., datë 5.2.2020.

⁴⁵ Referohu përgjigjes së pyetjes nr. 8 të pyetësorit nr. 2 të dërguar nga Komisioni.

51. Siç u pasqyrua më sipër, në DPV-të vjetore dhe në deklaratën “Vetting”, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie, por në përgjigje të pyetësorit ka deklaruar se si burim krijimi i kësaj pasurie kanë shërbyer të ardhurat e përfituara nga djali i tij si avokat.

51.1. Në deklaratën “Vetting”, në rubrikën ku pasqyrohen të ardhurat, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura të përfituara nga djali i tij, E.M., për periudhën 2007 – 2015, nga aktiviteti si avokat pajisur me NIPT ***, në vlerën totale 9,600,000 lekë (mesatarisht 100,000 lekë në muaj).

51.2. Konstatimi i ILDKPKI-së: mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të ardhurat e deklaruara nga aktiviteti privat si avokat, i djalit të subjektit, E.M.

Hetimi i kryer nga Komisioni

52. QKB-ja⁴⁶ informon se shtetasi E. Pelivan Malaj, i datëlindjes 1.12.1982, figuron i regjistruar: (i) si person fizik, pajisur me NUIS (NIPT) ***; (ii) si person fizik, pajisur me NUIS (NIPT) ***; (iii) si person fizik, i pajisur me NUIS (NIPT) ***; dhe (iv) si person fizik, i pajisur me NUIS (NIPT) ***.

52.1. Nga verifikimi i ekstrakteve historike konstatohet se:

- i. subjekti “****”, person fizik, me Nipt ***, është regjistruar në QKB në datën 11.10.2007, për ushtrim veprimtarie në fushën e avokatisë;
- ii. subjekti “****”, person fizik, me Nipt ***, është regjistruar në QKB në datë 7.5.2014, për ushtrim veprimtarie në fushën e avokatisë;
- iii. subjekti “****”, person fizik, me Nipt ***, me emër tregtar “****”, është regjistruar në datën 4.11.2015 në QKB, për ushtrimin e aktivitetit “Bar-bufe”, dhe;
- iv. subjekti “****”, person fizik me Nipt ***, me emër tregtar “****”, është regjistruar në datën 18.7.2016 në QKB, për ushtrimin e aktivitetit “Bar - kafe”.

52.2. Duke marrë në konsideratë faktin se automjeti i markës “Jaguar” është blerë në datën 16.10.2013, nisur edhe nga informacioni i QKB-së Komisioni kreu verifikime për subjektin “****”, person fizik, me Nipt ***, regjistruar në QKB, në datën 11.10.2007, për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e avokatisë, në Tiranë.

Pas verifikimeve të kryera në faqen zyrtare të QKB-së, Komisioni konstatoi se informacioni i përcjellë për subjektin E.M., person fizik, me Nipt *** nuk është i saktë, pasi rezulton se ky subjekt tregtar i përket shtetasit E. R.M., dhe jo personit të lidhur, z. E.P.M.

52.3. Gjithashtu, nga analiza e korrespondencës së mbajtur me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve⁴⁷ dhe Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë⁴⁸, konfirmohet fakti se ky subjekt nuk i përket personit të lidhur, djalit të subjektit të rivlerësimi, z. E. Pelivan Malaj.

52.4. Pra, rezulton se ai nuk ka qenë i regjistruar për ushtrimin e aktivitetit si avokat përpara vitit 2014 dhe si rrjedhojë, nuk mund të ketë përfiturar të ardhura të ligjshme nga ushtrimi i këtij aktiviteti.

⁴⁶ Shkresa nr. ***prot., datë 20.2.2020.

⁴⁷ Shkresa nr. *** prot., datë 28.1.2020 dhe kthim përgjigjeje e DPT-së nr. *** prot., datë 7.2.2020.

⁴⁸ Shkresa nr. *** prot., datë 21.1.2020 dhe kthim përgjigjeje e DRT-së Tiranë me nr. *** prot., datë 31.1.2020; shkresa *** prot., datë 8.6.2020 e DRT-së Tiranë.

52.5. Sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur ka kryer deklaram të pamjaftueshëm lidhur me burimin e krijimit të pasurisë së mësipërme, dhe si rrjedhim, duket se nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie.

52.6. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet/shpjegimet përfundimtare dhe për të depozituar prova të reja të mundshme, lidhur me konstatimin e bërë nga Komisioni.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

52.7. Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka parashtruar se *lidhur me këtë pasuri ka dhënë shpjegimet e tij në përgjigje të pyetësorëve dhe se në raportin e Komisionit⁴⁹ jepen fakte për regjistrimet e djalit të tij në QKB dhe niptet përkatëse. Në lidhje me barrën e provës për këtë episod, duhen marrë në konsideratë edhe kreditë huamarrëse që djali ka marrë në banka, të cilat përmenden në materialin rezultatet e hetimit administrativ, si edhe shpjegimet që janë dhënë në këtë rast në pyetësorët përkatës.*

Vlerësimi përfundimtar i Komisionit

53. Nga analiza e vetëdeklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur si edhe dokumentacionit të administruar në dosje lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues çmon se shpjegimet e dhëna me dërgimin e prapësimeve nuk janë bindëse dhe se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit.

Komisioni vëren se në prapësimet e tij subjekti pretendon se duhen marrë në konsideratë si burim i krijimit të kësaj pasurie edhe kreditë e marra nga djali i tij, të pasqyruara në rezultatet e hetimit administrativ.

53.1. Komisioni konstatoi se para periudhës tetor 2013, në vitin 2006 personi i lidhur, E.M., ka marrë dy kredi në Bankën Popullore, njëra në shumën 150,000 lekë (likuiduar brenda vitit) dhe tjetra në shumën 290,000 lekë (likuiduar në vitin 2007). Konstatohet se subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur në deklaratën periodike të vitit 2006 nuk i ka deklaruar këto kredi, dhe si rrjedhim, as destinacionin dhe burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për shlyerjen e tyre. Gjithashtu, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur të kenë deklaruar shtesë likuiditetesh në gjendje *cash* me burim të ardhurat nga këto kredi, të tilla që mund të mbarteshin deri në vitin 2013 dhe të shërbenin si burim krijimi për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi.

53.2. Krahas faktit se subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie në deklaratat periodike vjetore dhe as në deklaratën “Vetting”, si edhe faktit se me dërgimin e prapësimeve është përpjekur të ndryshojë apo të shtojë burimet e të ardhurave, të cilat kanë për blerjen e kësaj pasurie, të vetëdeklaruar më parë prej tij në përgjigje të pyetësorëve, Komisioni vëren se, gjithsesi, kreditë e marra në vitin 2006 nuk mund të mbulojnë blerjen e kësaj pasurie.

53.3. Për më tepër, subjekti i rivlerësimit duket se është kontradiktor në prapësimet e tij, pasi në shpjegimet e dhëna për 2 kreditë e marra nga personi i lidhur në vitin 2006 (të konstatuara nga Komisioni si të padeklaruara prej tij) ka sqaruar se *është i vërtetë fakti që i mosdeklarimit të dy kredive në shuma relativisht të vogla (150,000 lekë dhe 290,000 lekë), pasi nuk janë vlerësuar prej tij si detyrim për deklarimin e pasurisë dhe se ai vetë nuk ishte vënë në dijeni.*

⁴⁹ I referohet rezultateve të hetimit administrativ.

Nga sqarimet e dhëna prej personit të lidhur rezulton se këto kredi kanë qenë kredi konsumatore për nevoja vetjake dhe ndonjë udhëtim jashtë shtetit.

53.4. Gjithashtu, Komisioni vëren se analiza financiare e kryer⁵⁰ për vitin 2013 (vit në të cilin është blerë automjeti nga personi i lidhur) paraqitet me balancë negative fondesh në vlerë të konsiderueshme.

53.5. Sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur ka kryer deklaram të pamjaftueshëm lidhur me këtë pasuri dhe se nuk ka patur burime financiare të ligjshme për blerjen e saj.

53.6. I pyetur nga Komisioni, lidhur me të ardhurat e deklaruara në deklaratën “Vetting”, si të përfituara nga aktiviteti i djalit të tij si avokat për periudhën 2007 – 2015 në shumën 9,600,000 lekë, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, deklaroi se⁵¹ *djali i tij ka ushtruar veprimtarinë kryesisht në Tiranë dhe në Vlorë (Nipt: ***). Marrja e dokumentacionit plotësues pranë Dhomës Kombëtare të Avokatisë kërkon interesim personal të djalit të tij, gjë që për momentin është e pamundur.*

53.7. Por, ndërkohë në procesverbalin “Mbi shpjegimet e subjektit të deklaramit të pasurisë” të mbajtur në ILDKPKI⁵² në datën 29.1.2016, në përgjigje të pyetjes nr. 14, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se *djali i tij ka filluar aktivitetin e tij si avokat nga viti 2007, ndërsa aktiviteti i tij i regjistruar është formalizuar duke u regjistruar pranë DRT-së Vlorë në datën 7.5.2014. Regjistrimi është kryer me vonesë nisur edhe nga fakti se në ushtrimin e aktivitetit si avokat, më parë nuk është kërkuar Nipt, por vetëm regjistrimi pranë Dhomës së Avokatëve. Përpara kësaj periudhe, djali ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj Dhomës së Avokatisë.*

53.8. DRT-ja Vlorë⁵³ informon se subjekti “****”, person fizik, me Nipt ***, me aktivitet si avokat ndodhet në statusin “pasiv” nga data 3.4.2018 dhe se ky subjekt: (i) për vitin 2014 ka deklaruar qarkullimin në vlerën 40,000 lekë dhe humbje në vlerën 5,930 lekë; (ii) për vitin 2015 ka deklaruar qarkullimin në vlerën 150,000 lekë dhe fitimin në shumën 35,928 lekë; (iii) për vitin 2016 ka rezultuar me humbje në vlerën prej 26,224 lekë; dhe (iv) për vitin 2017 ka rezultuar me humbje në vlerën 21,916 lekë.

53.9. Sa më sipër, nga analiza e dokumentacionit të administruar në dosje rezulton se personi i lidhur nuk provon me dokumentacion justifikues ligjor të ardhurat e pretenduara nga aktiviteti i avokatisë, të deklaruara në shumën 9,600,000 lekë, për periudhën 2007 – 2015. Pas kalimit barrës së provës, me prapësimet e dërguara duket se subjekti nuk ka ngritur pretendime për të kundërshtuar rezultatin e hetimit administrativ/konstatimin e bërë nga Komisioni, lidhur me të ardhurat e deklaruara si të përfituara nga aktiviteti i avokatisë së djalit të tij, për periudhën 2007 – 2016.

54. Si konkluzion, trupi gjykues vlerëson se në deklaratën “Vetting” subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë dhe të pamjaftueshëm për të ardhurat e pretenduara nga aktiviteti i avokatisë i personit të lidhur.

⁵⁰ Tabela e analizës përmbledhëse financiare – aneksi 1 i këtij vendimi.

⁵¹ Përgjigja e pyetjes nr. 11 të pyetësorit nr. 3.

⁵² Përcjellë në Komision me shkresën nr. ***prot., datë 30.1.2020.

⁵³ Shkresat: (i) nr. *** prot., datë 24.1.2020; dhe (ii) nr. *** prot., datë 14.2.2020.

55. Pasuria e llojit “automjet” e markës “Volkswagen”⁵⁴, blerë në datën 20.5.2015 nga personi i lidhur, vajza e subjektit – R.H., (Malaj), për shumën 500,000 lekë. Si burim krijimi ka deklaruar të ardhurat e bashkëshortit të saj, z. G.H.

55.1. Deklarimi i kësaj pasurie në vite: nga verifikimi i DPV/2015, konstatohet se nuk është deklaruar kjo pasuri në deklarimin e bërë veçmas nga personi i lidhur, znj. R.H., (Malaj). Ndërsa në DPV/2016, në deklarimin e bërë veçmas, personi i lidhur ka deklaruar se disponon pasuri veçmas të regjistruar në emrin e saj, por nuk ka deklaruar llojin e pasurisë, të dhëna mbi të, periudhën e krijimit dhe as burimin e saj.

55.2. Konkluzioni i ILDKPKI-së për këtë pasuri: përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e ardhur nga DPSHTRR-ja.

Hetimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri

56. DPSHTRR-ja⁵⁵, informon se në emër të personit të lidhur, R. P. H., figuron i regjistruar automjeti i markës “Volkswagen”, tipi “Passat”, me targa AA***. Nga verifikimi i dosjes së këtij mjeti konfirmohet se në datën 20.5.2015, personi i lidhur e ka blerë⁵⁶ këtë pasuri për vlerën 500,000 lekë.

56.1. Lidhur me burimin e krijimit: siç u konstatua më sipër, personi i lidhur ka deklaruar se ky automjet është blerë me të ardhurat e bashkëshortit të saj, z. G.H., por nuk është depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të provuar burimin e të ardhurave të personit tjetër të lidhur.

56.2. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit, që në përputhje me pikën 4 të nenit 32 të ligjit 84/2016, personi tjetër i lidhur (bashkëshorti i vajzës së subjektit) të konfirmonte këtë marrëdhënie dhurimi, si edhe të depozitonte dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat z. G.H., të cilat sipas deklarimit kanë shërbyer si burim krijimi i kësaj pasurie.

56.3. Me prapësimet e dërguara pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se *për pasurinë e llojit automjet të markës “Volkswagen” të blerë në datën 20.5.2015 nga vajza e tij R. H., (Malaj), krahas vërtetimit të pagës së bashkëshortit të saj, dokument që i është bashkëlidhur deklaratës “Vetting”, paraqet si prova të dhënat e bankës BKT, dega Vlorë, për pagën e G.H., për periudhën 30 shtator 2011 deri në 31 dhjetor 2015 për pagën e tij si Drejtor i Degës së Albtelcom Vlorë, kopjen e kontratës përkatëse të blerjes, deklarimin e tij për këtë blerje në emër të gruas si edhe faqe të procesverbalit ku provohet dorëzimi prej tij i vërtetimit të pagës së tij (personit tjetër të lidhur).*

56.4. Nga analizimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI rezulton se, krahas kontratës së shitblerjes së këtij automjeti, subjekti ka depozituar vërtetimin⁵⁷ e “Albtelcom” sh.a., datë 26.1.2017, për të ardhurat vjetore neto nga puna të personit tjetër të lidhur, z. G. H., për vitet 2011 – 2015. Ndërsa, me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, lidhur me këtë marrëdhënie, subjekti ka depozituar si prova të reja: (i) deklaratë të nënshkruar nga zoti G. H., në datën 20.12.2020; dhe (ii) nxjerrje llogarie nga

⁵⁴ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së): kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 20.5.2015.

⁵⁵ Shkresa nr. *** prot., datë 5.2.2020.

⁵⁶ Kontratë shitblerjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.5.2015.

⁵⁷ Vërtetimi nr. *** prot., datë 26.1.2017 (ndodhur në aneksin *** në dosjen e ILDKPKI-së).

BKT-ja për llogarinë bankare të personit tjetër të lidhur, z. G.H., për periudhën 30.9.2011 – 31.12.2015.

56.5. Nëpërmjet deklaratës së nënshkruar prej tij (shkresë e thjeshtë) z. G.H., shpjegon se *për periudhën 2011 – 2015 ka qenë i punësuar në detyrën e drejtorit rajonal të “***” Vlorë, me një pagë të konsiderueshme sipas vërtetimit që është paraqitur pranë ILDKPKI-së. Bashkëshortja e tij, R.H., ka blerë në 20 maj të vitit 2015 një autoveturë tip “Volkswagen Passat” me të ardhurat e krijuara prej rrogës së tij.*

Ndërsa, nga verifikimi i lëvizjeve në llogarinë në lekë në BKT të personit tjetër të lidhur, z. G.H., vërehet se prej periudhës shtator 2011 – deri dhjetor 2015 ka kreditime të vazhdueshme/periodike me përshkrimin “Albtelecom sh.a. kalim/kalon paga/pagat...”.

56.6. Nga vlerësimi në harmoni i provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit me dorëzimin e deklaratës “Vetting” me shpjegimet dhe provat e depozituara me prapësimet e dërguara pas rezultateve të hetimit, Komisioni arrin në përfundimin se personi tjetër i lidhur ka patur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht dhënien e shumës 500,000 lekë bashkëshortes së tij, znj. R.H., e cila ka shërbyer si burim krijimi i pasurisë objekt vlerësimi.

57. Konstatohet se në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar pasurinë e llojit “apartment”⁵⁸, me sipërfaqe 75 m², të ndodhur pranë kopshtit zoologjik, ***, Tiranë, në bashkëpronësi me bashkëshorten, blerë nga shoqëria “***” sh.p.k., për shumën 45,000 euro.

57.1. Si burim krijimi të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar kredinë e marrë në “Intesa Sanpaolo Bank” (ish-Banka Amerikane) në vlerën 25,000 euro.

Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se këtë pasuri e ka shitur në datën 10.1.2017, për shumën 7,500,000 lekë.

57.2. Deklarimi i kësaj pasurie në vite: referuar DPV/2005 (në rubrikë të veçantë), subjekti ka deklaruar kontratën e porosisë për pasurinë e llojit “apartment”, 1+1, të lidhur me shoqërinë “***” sh.p.k., për vlerën 45,000 euro, shlyer shuma 29,000 euro, nga të cilat 20,000 euro me kredi. Gjithashtu, në rubrikën “detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti ka deklaruar kredinë bankare në Bankën Amerikane të Shqipërisë, në shumën 25,000 euro. Ndërsa në DPV/2006, subjekti ka deklaruar shlyerjen e shumës 3,000 euro, në zbatim të kontratës së porosisë së apartamentit në Tiranë, me firmën ndërtuese “***” sh.p.k.

57.3. Konkluzioni i ILDKPKI-së për këtë pasuri: (i) mungesë në procesin e rivlerësimit, e kontratës së blerjes së apartamentit në Tiranë, nga shoqëria “***” sh.p.k.; (ii) dyshime lidhur me çmimin e blerjes së apartamentit në ***, Tiranë, i cili në deklaratën e interesave privatë të vitit 2005 dhe në deklaratën e rivlerësimit, është deklaruar 45,000 euro (konfirmuar edhe nga kontrata e sipërmarrjes). Sipas kontratës nr. ***, datë 10.1.2017, të shitjes së këtij apartamenti, citohet se pala shitëse e ka blerë në shumën 2,890,000 lekë. Rivlerësimi në datën 20.1.2012 është bërë në shumën 4,920,600 lekë. Nga shuma e rivlerësimit gjykohet që blerja të mos jetë në shumën e deklaruar. (iii) nuk është deklaruar vazhdimësia e pagesave për likuidimin e vlerës totale të apartamentit në ***, Tiranë. Subjekti ka deklaruar në vitin 2005 pagesë 29,000 euro dhe në vitin 2006 pagesë në shumën 3,000 euro.

Hetimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri

⁵⁸ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneksi *** në dosjen e ILDKPKI-së): - (i) kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 10.1.2017; (ii) deklaratë noteriale nr. ***, e vitit 2017; (iii) kontratë paraprake shitjeje nr. ***, datë 19.12.2016.

58. ZVRPP-ja Tiranë⁵⁹, informon se në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij ka qenë e regjistruar pasuria e llojit “apartament”, me sipërfaqe 69.5 m², nr. ***, volum ***, faqe ***, zonë kadastrale ***. Nga verifikimi i kartelës së kësaj pasurie konstatohet se ajo është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes në datën 18.3.2010 dhe se vlera e shënuar si e paguar nga subjekti është 2,890,000 lekë, por vërehet se kjo zyrë hipotekore nuk ka dërguar dokumentacionin mbi bazën e të cilit kjo pasuri të jetë e regjistruar.

58.1. Sipas dokumentacionit të administruar si pjesë e dosjes së ILDKPKI-së për këtë pasuri (aneksi ***) konstatohet se në datën 20.4.2005 është lidhur kontrata e sipërmarrjes mes subjektit të rivlerësimit (gjeneralitet nuk janë paraqitur të sakta) dhe shoqërisë “****” sh.p.k., për porositjen e apartamentit, me sipërfaqe 69.5 m² në objektin që kjo shoqëri po ndërtonte në ***, ***, Tiranë, për çmimin 45,000 euro.

58.2. Në kontratë përcaktohet plani i pagesave si vijon: (i) kësti i parë do paguhet brenda datës 20 prill 2005, në shumën 9,000 euro; (ii) kësti i dytë në 30 shtator 2005, në shumën 10,000 euro; (iii) kësti i tretë në 30 janar 2006, në shumën 20,000 euro; dhe (iv) në 30 gusht 2006 do të paguhet 6,000 euro.

58.3. Ndërsa, sipas kontratës së shitjes⁶⁰ datë 18.2.2010, shoqëria “****”, i ka shitur subjektin të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, pasurinë e llojit “apartament”, me sipërfaqe 69.5 m², të ndodhur në ***, Tiranë, për shumën 2,890,000 lekë, shumë e cila deklarohet se është likuiduar plotësisht nga pala blerëse jashtë zyrës noteriale.

58.4. Në vijim, nëpërmjet kontratës paraprake të shitjes⁶¹ të datës 19.12.2016, e cila paraprin shitjen e kësaj pasurie, në deklaratimet e palëve, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij deklarojnë se e kanë blerë këtë pasuri për vlerën 2,890,000 lekë dhe se në datën 20.1.2012 është vlerësuar në vlerën 4,920,600 lekë. Në këtë kontratë është përcaktuar se çmimi i shitjes është 7.500.000 lekë, i cili të shlyhet në dy këste: kësti i parë në shumën 4,044,000 lekë brenda datës 20.12.2016 dhe diferenca në momentin e hartimit të kontratës përfundimtare.

58.5. Në datën 10.1.2017 është nënshkruar kontrata përfundimtare e shitjes⁶² për çmimin 7,500,000 lekë, të paguar si vijon: (i) kësti i parë në shumën 4,044,000 lekë është paguar nga blerësi për llogari të shitësit nëpërmjet llogarisë bankare “tjetërsim pasurie” të noterit E. H.; dhe (ii) kësti i dytë përfundimtar në shumën 3,456,000 lekë i është paguar shitësit jashtë zyrës noteriale dhe se palët deklarojnë se nuk kanë asnjë pretendim të sotëm apo të ardhshëm në lidhje me të.

58.6. Sa më sipër rezulton se: (i) ka mospërputhje të sipërfaqes së këtij apartamenti, mes deklaratimit të bërë nga subjekti rivlerësimit në deklaratën “Vetting”, (deklaruar 75 m²) dhe sipërfaqes së përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes dhe të shitjes (sip. 69.5 m²); si dhe (ii) ka mospërputhje të çmimit të blerjes së kësaj pasurie të deklaruar në DPV-në vjetore të vitit 2005, deklaratën “Vetting”, të parashikuar në kontratën e sipërmarrjes të datës 20.4.2005 (çmimi 45,000 euro) dhe çmimit të përcaktuar në kontratën e shitblerjes të datës 18.2.2010 (çmimi 2,890,000 lekë).

⁵⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 22.2.2019.

⁶⁰ Kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.2.2010

⁶¹ Kontratë paraprake shitjeje (për shitblerje pasurie të paluajtshme) nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.12.2016.

⁶² Kontratë shitblerjeje pasurie e paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.1.2017.

58.7. Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, lidhur me mospërputhjen në deklarimin e sipërfaqes së këtij apartamenti, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, shpjegoi se *në lidhje me pasurinë apartament me sipërfaqe 75 m² që nga regjistrimi i tij në ZVRPP Tiranë, rezulton të jetë 69.5 m², nuk është në përgjegjësinë e tij mospërputhja ndërmjet çfarë i ishte thënë nga firma ndërtuese në kontratën e sipërmarrjes dhe gjendjes faktike të saj. Në vijim deklaroi se, ai e ka ditur se është 75 m², prandaj e ka deklaruar të tillë, mund të jenë futur dhe sipërfaqet e përbashkëta, ndërkohë që ZRPP regjistron vetëm sipërfaqet përkatëse në pronësi të secilit pronar.*

58.8. Komisioni vëren se edhe në kontratën e sipërmarrjes sipërfaqja e saj është shënuar 69.5 m². Gjithsesi, trupi gjykues e vlerëson këtë pasaktësi në deklarim me peshë specifike shumë të vogël dhe, si e tillë, nuk ndikon në vendimmarrjen përfundimtare. Në këtë kuptim, Komisioni është fokusuar në verifikimin e vlerës së kësaj pasurie dhe ligjshmërisë së burimit të krijimit të saj.

58.9. I pyetur nga Komisioni për blerjen e kësaj pasurie (kohën e porositjes, çmimin e pasurisë, formën e kryerjes së pagesave dhe kohën e kryerjes së tyre), subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, deklaroi se⁶³ *fillimisht është bërë pagesa nëpërmjet kredisë bankare në shumën 20,000 euro. Ndryshimi nuk është deklaruar për shkak se ende kjo pasuri nuk ka qenë në disponim prej tij, sepse apartamenti ka qenë ende i pandërtuar, bile porosia është bërë që me themele. Momenti i deklarimit ka qenë pas posedimit real, bërjes së kontratës së shitjes dhe regjistrimit të kësaj pasurie në regjistrat e pasurisë së paluajtshme Tiranë. Apartamenti, për nevojat e ngutshme për banim të djalit në Tiranë, është marrë nga firma ndërtuese pa përfunduar punimet e rifiniturës. Në vlerën e përgjithshme të apartamentit, përveç shumë punimeve të shtrimeve, instalimeve elektrike dhe punime të tjera të pllakave e hidrosanitareve, janë edhe vlera e mobilimit të këtij apartamenti prej rreth 700,000 lekë, kryer në disa vite.*

59. Nga analiza e shpjegimeve të dhëna më sipër, vërehet se, deklarimet e subjektit, të dhëna gjatë hetimit administrativ, nuk përputhen me deklarimet e bëra prej tij ndër vite në ILDKPKI, pasi rezultoi se në DPV/2010 nuk është deklaruar kjo pasuri dhe as kontrata e shitblerjes së saj. Siç u theksua edhe më sipër, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të dhëna për këtë pasuri në DPV- të viteve 2005 dhe 2006 dhe më pas e ka deklaruar në deklaratën “Vetting” me vlerë 45,000 euro.

59.1. Në vijim, duke qenë se subjekti i rivlerësimit nuk dha shpjegime për të gjitha çështjet e ngritura për këtë pasuri, u përsërit kërkesa nëpërmjet një pyetësi të ri⁶⁴. Në përgjigje të tij, subjekti, ndër të tjera, deklaroi se *në lidhje me këtë pyetje, ka bërë përpjekje që me rastin e ardhjes së pyetësit nr. 2 (pyetësi i mëparshëm) që të marrë informacion nga firma ndërtuese për çështjet që ngrihen në pyetësor, me qëllim dhënien e përgjigjeve të drejta.*

59.2. Shoqëria “****” sh.p.k.⁶⁵ informon se *z. Pelivan Malaj, në datën 20.4.2005, ka nënshkruar një kontratë sipërmarrjeje për ndërtimin e një pasurie të paluajtshme të tipit “apartament” me sip. 69.5 m², në zonën e *** Tiranë. Kjo kontratë sipërmarrjeje ka pasur si çmim vlerën 45,000 euro. Në datën 26.7.2005, z. P.Malaj i është drejtuar shoqërisë me një kërkesë në të cilën kërkonte që në apartamentin e porositur prej tij të mos realizoheshin një sërë punimesh. Shoqëria “****”, duke vlerësuar se zërat e punimeve të listuara në të nuk ndikonin në realizueshmërinë me cilësi të punimeve të tjera të godinës, e miratoi atë.*

⁶³ Përgjigjja e pyetjes nr. 7 të pyetësit nr. 2.

⁶⁴ Pyetësi nr. 3.

⁶⁵ Shkresa nr. *** prot., datë 14.5.2020, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 15.5.2020.

Gjithashtu përlllogariti dhe vlerën e punimeve që nuk do të realizoheshin në 2.533.472 lekë ose 21,021 euro. Kjo vlerë i zbritet çmimit të kontratës së sipërmarrjes.

59.3. Bashkëlidhur kësaj shkrese shoqëria ka bashkëlidhur pasqyrën përmbledhëse të punimeve të përfunduar, në të cilën konstatohen zëra punimesh të papërcaktuara në kontratën e sipërmarrjes, e konkretisht: (i) tavan i varur me kartonxhes në vlerën 96,460 lekë; (ii) punime kondicionimi në vlerën 137,501 lekë; (iii) pajisje kondicionimi në vlerën 555,560 lekë; dhe (iv) set kuzhine në vlerën 216,300 lekë.

59.4. Nga analiza e të dhënave të mësipërme, vërehet se, shuma prej 1,005,821 lekësh përfaqëson punime/arredime, të cilat shoqëria ndërtuese nuk i ka pasur pjesë të kontratës së sipërmarrjes, si rrjedhim, edhe të çmimit të kësaj kontrate, në vlerën 45.000 euro. Gjithashtu, nga shoqëria nuk është përcaktuar koha dhe vlera e pagesave të kryera nga subjekti i rivlerësimit për blerjen e këtij apartamenti.

59.5. Gjithashtu konstatohet se, pavarësisht deklarimit të palëve në kontratën e shitjes së datës 18.2.2010, se çmimi i blerjes së apartamentit është likuiduar nga blerësi jashtë zyrës noteriale, rezulton se në datën 14.12.2010 është transferuar në llogari të shoqërisë “****” sh.p.k. edhe shuma 5,000 euro. Në prapësimet pas rezultateve të hetimit, subjekti u qëndron të gjitha shpjegimeve dhe provave të depozituara prej tij gjatë hetimit administrativ, për vlerën e blerjes së kësaj pasurie.

59.6. Nëse analizohen vetëm deklaratimet periodike vjetore të bëra nga subjekti në ILDKPKI dhe pagesat e kryera me transfertë bankare në favor të shoqërisë “****” sh.p.k., nga ku rezulton se: (i) në DPV/2005 subjekti ka deklaruar shlyerjen e shumës 29,000 euro⁶⁶; (ii) në DPV/2006 ka deklaruar shlyerjen e shumës 3,000 euro; (iii) në vitin 2010 rezulton pagesa e kryer me transfertë bankare në shumën 5,000 euro, arrihet në përfundimin se shuma totale e tyre është më e lartë se vlera e pretenduar nga subjekti si vlerë përfundimtare e blerjes së kësaj pasurie.

60. Nisur nga fakti se subjekti nuk ka deklaruar në vazhdimësi pagesat e kryera dhe detyrimet e mbetura në favor/ndaj shoqërisë “****”, me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi të shpjegojë në mënyrë kronologjike pagesat e kryera në favor të saj për likuidimin e çmimit për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi, si dhe depozitimin e dokumentacionit justifikues ligjor në mbështetje të deklaratimeve të tij. Gjithashtu, subjektit iu kërkua të shpjegojë arsyet se përse në kontratën e shitjes së kësaj pasurie është përcaktuar çmim më i ulët nga ai i parashikuar në kontratën e sipërmarrjes.

60.1. Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti referon vetëm pagesën e kësaj të parë në vlerën 9,000 euro, me burim të ardhurat nga avokatia, duke shpjeguar ndër të tjera se *nuk ka mbajtur dokumentacion për vlerën e paguar ndër vite për pagesat plotësuese të këtij apartamenti. Në vijim ai deklaroi se në vlerën e deklaruar të këtij apartamenti është edhe mobilimi, i deklaruar në deklaratën e pasurisë dhe atë “Vetting”. Vlera 5,000 euro e mbetur pas marrjes së kredisë është përdorur edhe kjo për pagesat e mëvonshme për mobilim.*

60.2. Komisioni vëren se subjekti nuk ka qenë i qartë në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ dhe ato të depozituara me prapësimet pas rezultateve të hetimit për këtë pasuri, duke mos iu përgjigjur drejtpërdrejt të gjitha pyetjeve. Deklarimet e tij janë kontradiktore, të pamjaftueshme dhe nuk shpjegojnë plotësisht dhe në mënyrë shteruese vlerën e paguar ndër

⁶⁶ Nga të cilat shuma 20,000 euro rezulton si e paguar nëpërmjet transfertës bankare.

vite për blerjen e kësaj pasurie dhe burimin e të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për krijimin e saj.

60.3. Si konkluzion, nga analizimi në harmoni i deklarimeve periodike vjetore të bëra nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI dhe pagesës me transfertë bankare në favor të shoqërisë ndërtuese në vitin 2010 me kontratën e sipërmarrjes së datës 20.4.2005, si edhe nisur nga vetëdeklarimi i bërë në DPV/2005 dhe deklaratën “Vetting” për vlerën e kësaj pasurie (deklaruar 45,000 euro), trupi gjykues krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit e ka blerë këtë pasuri për vlerën 45,000 euro.

Analiza e të ardhurave të deklaruara si burim për krijimin e kësaj pasurie

61. Siç u theksua më sipër, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi të kësaj pasurie vetëm kredinë e marrë në “Intesa Sanpaolo Bank” (ish-Banka Amerikane) në vlerën 25,000 euro. Sipas informacionit/dokumentacionit nga banka⁶⁷ rezulton se me kontratën e kredisë bankare të datës 19.12.2005, me kredihënës Bankën Amerikane të Shqipërisë, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë marrë/përfitur kredinë bankare⁶⁸ në shumën 25,000 euro, me qëllim blerjen e apartamentit të ri në Tiranë. Përcaktohet se kredia do të jepet në dy këste: kësti parë në shumën 20,000 euro dhe kësti i dytë në shumën 5,000 euro, pas regjistrimit të apartamentit në ZVRPP.

61.1. Konstatohet se në llogarinë në emër të subjektit të rivlerësimit në euro (llogaria nr. 6499235101), në datën 23.12.2005, është disbursuar kësti i parë i kredisë në shumën 20,000 euro dhe se në të njëjtën datë kjo shumë është transferuar në llogari të shoqërisë “****” sh.p.k. Ndërsa, kësti i dytë në vlerën 5,000 euro është disbursuar në llogari të subjektit në datën 14.12.2010 dhe se në të njëjtën ditë është transferuar në llogari të shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k.

61.2. Në përputhje me konkluzionin e mësipërm, duke iu referuar vlerës së blerjes së kësaj pasurie në shumën 45,000 euro⁶⁹, Komisioni konstaton se në deklaratën “Vetting” subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për burimin e krijimit të kësaj pasurie, pasi shuma e përfitur nga kredia bankare (vlera 25,000 euro) ka qenë e pamjaftueshme për të mundësuar plotësisht blerjen e saj.

61.3. Nga analiza e të gjithë dokumentacionit ligjor të administruar në dosje⁷⁰, Komisioni vlerëson se pagesat e kësteve për blerjen e kësaj pasurie janë kryer si vijon: (i) pagesa e kështit të parë⁷¹ në shumën 9,000 është kryer në datën 20.4.2005; (ii) pagesa e kështit të dytë⁷² në shumën 20,000 euro është kryer në datën 23.12.2005; (iii) pagesa e kështit të tretë⁷³ në shumën

⁶⁷ Shkresa nr. *** prot., datë 5.2.2020, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 18.2.2020.

⁶⁸ Kontratë kredie bankare nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.12.2005.

⁶⁹ Sipas kontratës së sipërmarrjes të datës 20.4.2005, deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në DPV/2005 dhe deklaratën “Vetting”.

⁷⁰ DPV-të vjetore, kontratë sipërmarrjeje + kontratë shitblerjeje + dokumentacioni bankar.

⁷¹ Përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes se pagesa e kështit të parë në shumën 9,000 euro do të kryhet brenda datës 20.5.2005.

⁷² Rezultoi si pagesë e kryer nëpërmjet transaksionit bankar me të ardhurat e përfituara nga kredia.

⁷³ Nisur nga përcaktimet e bëra në kontratën e sipërmarrjes se kësti i tretë do të paguhet më 30 janar 2006 në shumën 20,000 euro dhe se në 30 gusht 2006 do të paguhet 6,000 euro, si edhe duke konsideruar faktin se gjatë vitit 2005 subjekti ka deklaruar pagesën e kryer në favor të shoqërisë në shumën 29,000 euro dhe pasqyrimin të pagesës 5,000 euro të bërë në vitin 2010 nëpërmjet transfertës bankare si kësti i fundit për blerjen e kësaj pasurie (parashikuar si moment pagese në kontratën e kredisë me regjistrimin e kësaj pasurie në ZVRPP - fakt i ndodhur në vitin 2010), rrjedhimisht vlerësohet se në vitin 2006 nga subjekti i rivlerësimit është paguar shuma 11,000 euro.

11,000 euro është kryer brenda vitit 2006; dhe (iv) pagesa e kështit të katërt (të fundit)⁷⁴ në shumën 5,000 euro është kryer në datën 14.12.2010.

61.4. Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1.1.2005 - 20.4.2005 për të verifikuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur për kryerjen e kësaj pagese, pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Tabela nr.7

Analiza financiare – periudha 1.1.2005- 20.4.2005	
Pershkrimi	Shuma në lekë
Të ardhurat neto nga pagat e subjektit, për periudhën	321,901
Të ardhurat neto nga pensioni i bashkëshortes, për periudhën	44,224
Total të ardhura/të hyra financiare	366,125
Pagesë shpenzime për jetesë - periudha	99,052
Total shpenzime/të dala financiare	99,052
Ndryshim mj.monetare cash, gj.fillim - gj.fund periudhe, deklaruar	0
Ndryshim mj.monetare bankë, gj.fillim - gj.fund periudhe, referuar dok. bankar	-36,224
Mjete monetare të disponueshme (1)	230,849
Pagesa për blerje pasurie shuma 9,000 euro, datë 20.4.2005	1,102,860
Pasuri neto (2)	1,102,860
Balanca e fondeve (1-2)	- 872,011

61.5. Sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagesën e kështit të parë në shumën prej 9,000 euro në datën 20.4.2005, për blerjen e pasurisë së llojit “apartament” nga shoqëria “****” sh.p.k.

62. Pasuri të paluajtshme, të padeklaruara nga subjekti i rivlerësimit/personat e lidhur

62.1. Konstatohet se me kontratën e shitblerjes⁷⁵ (sendi të ardhshëm - apartament banimi në ndërtime) të datës 15.12.2015, personi i lidhur, z. E.M., (pala blerëse e ardhshme), ka blerë nga shoqëria “****” sh.p.k. dhe subjekti “****” person fizik, apartamentin me sipërfaqe 73.81 m², ndodhur në lagjen “****”, Vlorë, për çmimin 6,300,000 lekë.

62.2. Në nenin 2 të kontratës, me titull “Kushtet e shitblerjes, çmimi dhe likuidimi” përcaktohet se është pranuar mes palëve që çmimi i shitblerjes së pasurisë të jetë në total 6,300,000 lekë dhe likuidimi do të bëhet me këste si vijon:

(i) me lidhjen e kontratës palët deklarojnë se është likuiduar çmimi në shumën 300,000 lekë,
(ii) kësti i dytë në shumën 5,000,000 lekë do të likuidohet nëpërmjet një kredie bankare që blerësi është i interesuar të përfitojë në BKT, dega Vlorë; dhe
(iii) likuidimi i shumës së mbetur 1,000,000 lekë do të realizohet në momentin e lidhjes dhe nënshkrimit nga palët të kontratës përfundimtare të shitblerjes. Palët deklarojnë se nuk kanë pretendime për çmimin dhe mënyrën e pagesës.

62.3. Sipas informacionit/dokumentacionit nga BKT-ja⁷⁶, rezulton se në llogarinë e personi të lidhur në lekë (llogaria me nr. **) në datën 15.12.2015 është depozituar *cash* prej tij shuma

⁷⁴ Rezulton si pagesë e kryer nëpërmjet transaksionit bankar, me të ardhurat e përfituara nga kredia.

⁷⁵ Kontratë shitblerjeje nr. ** rep., nr. ** kol., datë 15.12.2015.

⁷⁶ Shkresa nr. ** prot., datë 10.2.2020, protokolluar në Komision me nr. ** prot., datë 11.2.2020.

300,000 lekë dhe se në datën 16.12.2015 kjo shumë është transferuar në favor të shoqërinë ndërtuese “****” sh.p.k., me përshkrimin “pagesë kësti për blerje apartamenti”.

62.4. Në vijim, në datën 31.12.2015 në këtë llogari është disbursuar një kredi në vlerën 5,000,000 lekë dhe në të njëjtën ditë shuma 4,935,260 lekë është transferuar në llogari të noteres I.B., me përshkrimin “pagesë për blerje apartamenti sipas kontratës” .

Gjithashtu, rezulton se kredia e disbursuar në datën 31.12.2015 është shlyer në datën 20.12.2016, me transfertë nga noteri E. H., me të ardhurat nga shitja e apartamentit në Selitë, Tiranë, nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij.

62.5. Në kontratën e kredisë bankare dhe hipotekore⁷⁷ të datës 21.12.2015, personi i lidhur, E.M., shfaqet në cilësinë e kredimarrësit, ndërsa subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij shfaqen si dorëzanës. Si kolateral është lënë apartamenti në pronësi të subjektit dhe bashkëshortes së tij, i ndodhur në ****, Tiranë.

62.6. Rezulton se në DPV/2015, DPV/2016 dhe në deklaratën “Vetting”, kjo pasuri (të drejtat reale mbi të) nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe as nga personi i lidhur në deklarin e bërë veçmas. Gjithsesi, konstatohet se në deklaratën “Vetting”, në rubrikën “detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” subjekti ka deklaruar kontratë kredie bankare të datës 21.12.2015, në shumën 5,000,000 lekë, të marrë nga djali i tij. Gjithashtu ka deklaruar se kjo kredi është mbyllur tërësisht me nga të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në ****, Tiranë dhe ato të përfituara nga shpronësimi i zyrës së avokatisë. Ky detyrim - kjo kredi nuk është deklaruar në DPV/2015, por, Komisioni konstaton se në DPV/2016 subjekti e ka deklaruar këtë kredi, duke shpjeguar se ajo është lëvruar në datën 5.1.2016.

62.7. I pyetur lidhur me mosdeklarimin e kësaj pasurie, si edhe burimin e të ardhurave për pagesën e shumës 6,300,000 lekë për blerjen e saj, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, deklaroi se *kjo kontratë nuk është finalizuar, është kontratë paraprake (sendi i ardhshëm), e cila ka qenë e inkuadruar në kredinë përkatëse që djali i tij, E.M., kishte marrë nga BKT-ja, dega Vlorë. Kontrata e mësipërme e kredisë, ku përfshihet edhe kontrata me firmën ndërtuese është deklaruar vit pas viti në deklaratën vjetore dhe atë përfundimtare të Vettingut.*

62.8. Sa më sipër, nga analiza e kryer nga Komisioni për këtë pasuri, në kuptim të ligjit për deklarin e pasurive, si edhe ligjit nr. 84/2016, rezulton se:

- i. subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015; (i) pasurinë e prenotuar nga personi i lidhur, të drejtat reale mbi të; (ii) pagesat e kryera për këtë pasuri gjatë këtij viti (si shpenzime të kryera); dhe (iii) kredinë e marrë në BKT nga personi i lidhur (si detyrim);
- ii. subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” këtë pasuri - të drejtat reale mbi të, pagesat e kryera për këtë pasuri/ detyrimet e mundshme të mbetura, nëse e ka marrë në dorëzim/nëse e ka në përdorim këtë pasuri, si edhe burimin e krijimit të saj.
- iii. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe provat e tij në lidhje me këto konstatimet.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

⁷⁷ Kontratë kredie bankare dhe hipotekore nr. **** rep., nr. **** kol., datë 21.12.2015.

63. Subjekti ka argumentuar se kjo kontratë nuk u finalizua dhe se personi i lidhur: (i) nuk provohet të ketë qenë palë blerëse; (2) ka hequr dorë nga blerja e sendit të ardhshëm⁷⁸, vullnet i cili është pranuar nga firma ndërtuese dhe personi fizik “****”; (3) i janë kthyer lekët e çmimit të përcaktuar sipas kontratës së datës 15.12.2015. Në këtë kuptim, duket se subjekti u qëndron shpjegimeve të bëra më parë në përgjigje të pyetësorëve, në thelb të të cilave pretendon se për sa kohë kontrata nuk është finalizuar dhe personi i lidhur nuk e ka blerë apo marrë në dorëzim këtë pasuri, nuk ka patur detyrimin për deklarimin e saj.

63.1. Në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”, në rubrikën “detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti ka deklaruar kontratë kredie datë 11.11.2010, në “Intesa SanPaolo Bank”, me afat 10 vjet (për blerjen e një zyre avokatie për djalin E.M.), në shumën 40,000 euro. Ndërsa, në deklarimin periodik të vitit 2010, rezulton e deklaruar kredi bankare për të njëjtin qëllim e në të njëjtën shumë në “ISP Bank”, filluar më 25.12.2010.

63.2. Konstatohet se nëpërmjet kontratës premtim shitjeje njësi shërbimi⁷⁹ të datës 9.10.2010 (pjesë e dosjes së kredisë si edhe administruar në dosjen e ILDKPKI-së – ankesi 42), pala blerëse e ardhshme Pelivan dhe Gj.M., kanë rënë dakord të blejnë nga shoqëritë “****” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k., pasurinë e llojit “njësi shërbimi”, për vlerën 72,000 euro. Në këtë kontratë përcaktohet dakordësia e palëve që kjo shumë do të likuidohet: (i) në datën e nënshkrimit të kontratës shuma 28,000 euro; (ii) deri në datën 21.12.2010 kësti i dytë në vlerën 40,000 euro; dhe (iii) diferenca e ngelur 4,000 euro do të likuidohet me marrjen në dorëzim të njësisë së shërbimit.

63.3. Konstatimet e ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri:

- i. mungesë në procesin e rivlerësimit të dokumentacionit justifikues ligjor për konkretizimin e qëllimit të marrjes së kredisë në vitin 2010, në “ISP Bank”, në shumën 40,000 euro;
- ii. fshehje e njësisë – zyrës së avokatisë, si në deklaratat e interesave private që nga viti 2010, kur është marrë kredia dhe lidhur kontrata e premtim shitjes, ashtu edhe në deklarimin “Vetting” (në vitin 2010 është deklaruar se kredia në “ISP Bank”, është marrë për blerje zyre avokatie, pa të dhëna të tjera). Rrjedhimisht, ka mungesë deklarimi nëse është blerë ky aset, sa është vlera totale e tij, sa është shuma e likuiduar deri në “Vetting”, identitetin e palës shitëse, vendndodhjen dhe të dhënat fizike të pronës;
- iii. fshehje e shumës 28,000 euro, likuiduar me lidhjen e kontratës, në vitin 2010, si edhe të pagesave të tjera pjesore, nëse ka patur, referuar termave të kontratës. Sa i përket burimit financiar, gjykohet që pjesërisht të jetë kredia e deklaruar.

Hetimi/analiza e kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

64. Rezulton⁸⁰ se në datën 11.11.2010 është lidhur kontrata e kredisë bankare mes “Intesa SanPaolo Bank” si palë kredidhënëse dhe subjektit dhe bashkëshortes së tij, si palë kredimarrëse, për dhënien e një kredie në shumën 40,000 euro, me qëllim blerjen e një “njësie – dyqani të ri”. Si kolateral është vendosur apartamenti me sipërfaqe 120 m², i ndodhur në Vlorë, në pronësi të kredimarrësve.

⁷⁸ Subjekti ka depozituar si provë të re deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.1.2017, të noterit publik, znj. I.B.

⁷⁹ Kontratë premtim shitjeje njësi shërbimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.10.2010.

⁸⁰ Shkresa nr. *** prot., datë 5.2.2020, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 18.2.2020.

64.1. Kredia rezulton se është disbursuar në llogarinë e subjektit në datën 18.11.2010 dhe po në të njëjtën datë është transferuar në llogari të shoqërisë “****” sh.p.k., shuma 39.300 euro, me përshkrim “për blerje ambient të ri”.

64.2. I pyetur nga Komisioni për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se⁸¹ *kjo zyrë nuk u ble dhe kontrata nuk u finalizua, për shkak se janë penguar punimet.*

Subjektit iu kërkuan shpegime për: (i) mënyrën e dhënies së shumës prej 28,000 euro; (ii) burimin e të ardhurave për këtë shumë (iii) nëse janë kthyer shumat e paguara prej tij (shuma 28,000 euro paguar ditën e nënshkrimit të kontratës si edhe shuma 39,300 euro paguar me bankë); (iv) koha dhe mënyra e kthimit të tyre.

Në përgjigje të sa më sipër, subjekti deklaroi se *deklarimi i marrëdhënies së kredisë dhe situacionet vjetore për këtë kredi, ka menduar se ka qenë i mjaftueshëm. Kjo kredi është riformatuar më pas dhe është shlyer me shumën 2,600,000 lekë të kontratës së kredisë datë 23.2.2017, në shumën 6,600,000 lekë të lidhur po me këtë bankë ku është futur dhe bashkëkredimarrës edhe djali E.M.*

64.3. Ndërsa, në procesverbalin e datës 29.1.2016 “Mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive”⁸², subjekti ka deklaruar se në favor të shoqërive “****” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k., është paguar vlera 30,000 euro me kredinë e marrë në “ISP Bank” dhe ka mbetur detyrim shuma 37,000 euro.

64.4. Sa më sipër, nga analiza e kryer nga Komisioni për këtë pasuri, në kuptim të ligjit për deklarimin e pasurive, si edhe ligjit nr. 84/2016, rezulton se:

- a) subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010 pasurinë e prenotuar prej tij – të drejtat reale mbi të, pagesat e kryera gjatë këtij viti (si shpenzime të kryera), si edhe burimin e të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për pagesat e kryera.
- b) subjekti nuk e ka deklaruar në deklaratën “Vetting” këtë pasuri – të drejtat reale mbi të, pagesat e kryera /detyrimet e mundshme të mbetura, nëse e ka marrë në dorëzim/nëse e ka në përdorim, si edhe burimin e krijimit të saj.
- c) subjekti ka kryer deklarim të pamjaftueshëm. Ai nuk ka qenë i qartë në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit të kryer nga Komisioni, duke mos u treguar bashkëpunues, pasi, megjithëse deklaroi se *kjo zyrë nuk u ble dhe kontrata nuk u finalizua, për shkak se janë penguar punimet*, nuk shpjegon kronologjinë e pagesave të kryera prej tij ndër vite, nëse është revokuar kontrata e porosisë dhe nëse i janë kthyer shumat e paguara prej tij.

Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe provat e tij në lidhje me konstatimet e bëra për këtë pasuri.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

65. Në prapësimet e tij, subjekti u ka qëndruar shpjegimeve të dhëna më parë Komisionit, duke argumentuar në mënyrë të përmbledhur se, në deklaratat periodike vjetore ka deklaruar kredinë e marrë prej tij në “ISP Bank” në datën 11.11.2010 për blerjen e një zyre avokatie, kështu e shlyera dhe gjendjen e detyrimit të mbetur, duke sqaruar se nuk ka pasur fshehje në deklarim, për sa kohë aseti nuk mund të deklarohet, pasi ai nuk u ble dhe shitja nuk u realizua, për shkak se u penguan punimet.

65.1. Në kontratën e premtim shitjes për njësi shërbimi të datës 9.10.2010, përcaktohet se me lidhjen e saj është likuiduar nga pala blerëse e ardhshme (Pelivan dhe Gj.M.) shuma 28,000 euro. Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1.1.2010 - 9.10.2010, për të verifikuar

⁸¹ Përgjigjja e pyetjes nr. 9 të pyetësorit nr. 2.

⁸² Përcjellë në Komision me shkresën nr. *** prot., datë 30.1.2020.

mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur për kryerjen e kësaj pagese, pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 8

Analiza financiare 1.1.2010 - 9.10.2010	
Pershkrimi	Shuma në lekë
Të ardhurat neto nga pagat e subjektit, periudha 1.1.2010 - 9.10.2010	955,754
Të ardhurat neto nga pensioni bashkëshortes, periudha 1.1.2010 - 9.10.2010	120,136
Të ardhura interesa	20,771
Total të ardhura/të hyra financiare	1,096,661
Shpenzime udhëtimi Itali, mars 2010, subjekti	45,794
Pagesë kredie për periudhën në “Raiffeisen” - subjekti	34,450
Pagesë kredie për periudhën në “ISP Bank” - subjekti	299,356
Pagesë kredie për periudhën në “Raiffeisen” – djali i subjektit	189,923
Pagesë shpenzime jetesë periudha	307,395
Total shpenzime /të dala financiare	876,918
Ndryshim mj.monetare cash gj.fillim - gj.fund periudhe deklaruar	0
Ndryshim mj.monetare gj.fillim - gj.fund periudhe, referuar dokumentacionit bankar	407,589
Mjete monetare të disponueshme (1)	627,332
Pagesa për blerje pasurie shuma 28.000 euro, datë 9.10.2010	3,870,440
Pasuri neto (2)	3,870,440
Balanca e fondeve (1-2)	- 3,243,108

65.2. Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar pagesën e kështit të parë në shumën 28,000 euro në datën 9.10.2010 – për blerjen e pasurisë së llojit “njësi shërbimi” nga shoqëritë “*” sh.p.k. dhe “***” sh.p.k.**

Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe provat e tij në lidhje me konstatimin e mësipërm.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

66. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se *shuma 28,000 euro është pjesë e shumës së përgjithshme prej 39,000 eurosh nëpërmjet bankës dhe konfondimi në këtë rast nuk qëndron. Nuk del gjëkund dhe nuk është e vërtetë që në favor të firmës ndërtuese të jetë paguar shuma prej 67,300 euro, sepse kjo aftësi paguese nuk mund të realizohet kurrë.* Subjekti pretendon se e vetmja pagesë e kryer në favor të shoqërisë ndërtuese është ajo e kryer nëpërmjet bankës, me burim të ardhurat nga kredia e marrë në “ISP Bank”, në vlerën 40,000 euro.

Analiza përfundimtare e kryer nga Komisioni/vlerësimi i provave

67. Pasi vlerësoi me paanësi dhe objektivitet shpjegimet e dhëna pas dërgimit të rezultateve të hetimit, duke i ballafaquar me provat e administruara në dosje për këtë pasuri, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit, pasi shpjegimet e tij janë të karakterit deklarativ dhe të pambështetura në dokumentacion provues.

67.1. Neni 659 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë përcakton: “Kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike”. Neni 660 i Kodit Civil parashikon se: “Palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufijve të vendosura nga legjislacioni në fuqi”. Neni 663 i Kodit Civil përcakton kushtet e nevojshme për lidhjen dhe vlefshmërinë e kontratës, të cilat janë: “Pëlqimi i palës që merr përsipër detyrimin; shkaku i ligjshëm në të cilin mbështetet detyrimi; objekti që formon lëndën e kontratës dhe forma e saj e kërkuar nga ligji”. Ndërsa, neni 690 i Kodit Civil parashikon se: “Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të priset ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj”.

67.2. Për sa kohë në kontratën e premtim shitjes së kësaj pasurie është përcaktuar shprehimisht: “Sot më datë 9.10.2010 pala blerëse likuidoi vlerën prej 28,000 euro”, në përputhje me dispozitat e mësipërme, ky trup gjykues vlerëson se nuk ekziston asnjë shkak ligjor që të vërë në dyshim vërtetësinë e fakteve të përshkruara në kontratën noteriale premtim shitjeje njësie shërbimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.10.2010, përfshirë këtu edhe çmimin dhe planin e pagesave të përcaktuara nga palët.

67.3. Si konkluzion, trupi gjykues i qëndron konstatimit dhe rezultatit fillestar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar pagesën e kështit të parë për pasurinë objekt vlerësimi.

68. Konstatohet se në DPV/2017 subjekti ka deklaruar ristrukturimin e kredisë së datës 11.11.2010 në “ISP Bank” duke e përfshirë në kontratën e kredisë të datës 23.2.2017 në të njëjtën bankë, në shumën 6,600,000 lekë, me afat 10-vjeçar. Nga verifikimi i informacionit/dokumentacionit nga “ISP Bank”⁸³ rezulton se në datën 23.2.2017 subjekti i rivlerësimit dhe djali i tij, z. E.M., (në cilësinë e kredimarrësve), kanë lidhur kontratën e kredisë bankare⁸⁴ nëpërmjet të cilës kanë marrë/përfutur kredinë në vlerën 6,600,000 lekë. Në kontratë, ndër të tjera, përcaktohet se, pas disbursimit të kredisë shuma 4,000,000 lekë do transferohet në llogarinë e noterit, ndërsa diferenca e fondeve të përdoret për mbylljen e kredisë pranë “Intesa San Paolo”.

68.1. Rezulton se pas lëvrimit/d disbursimit të kredisë në llogarinë nr. ***, në datën 1.3.2017, po në të njëjtën datë nga kjo llogari subjekti i rivlerësimit dhe djali i tij kanë transferuar shumën 4,000,000 lekë në llogarinë e noterit publik, znj. I.B., me përshkrimin “blerje apartamenti E.M, nr. repertori ***, nr. koleksioni ***, datë 10.1.2017”.

68.2. Sa më sipër, nga verifikimi i deklaratës “Vetting” dhe DPV/2017 si edhe nga analiza e informacionit të referuar më sipër, në kuptim të ligjit për deklarimin e pasurive, si edhe ligjit 84/2016, rezulton se:

- i. subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” këtë pasuri të porositur/blerë në datën 10.1.2017 - të drejtat reale mbi të, pagesat e kryera /detyrimet e mundshme të mbetura, nëse e ka marrë në dorëzim/nëse e ka në përdorim, si edhe burimin e krijimit të saj.
- ii. subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur nuk ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2017 këtë pasuri/të drejtat reale mbi të, pagesat e kryera gjatë këtij viti (si shpenzime të kryera), detyrimet e mundshme, si edhe burimin e të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për pagesat e kryera.

⁸³ Shkresa nr. *** prot., datë 5.2.2020, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 18.2.2020.

⁸⁴ Kontrata kredie bankare me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.2.2017.

68.3. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe provat e tij në lidhje me konstatimet e bëra, si edhe iu kërkua të depozitonte dokumentacionin e plotë për blerjen e kësaj pasurie, pagesat e kryera dhe deklarin e burimit të këtyre pagesave, të shoqëruar me dokumentacion justifikues ligjor.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

69. Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se *ristrukturimi i kredisë në ISP Bank, i kryer më datë 10.7.2017 nuk është deklaruar në deklaratën “Vetting” për shkak se nuk përfshihej në periudhën deklaruese. Kjo marrëdhënie nuk është fshehur, por është deklaruar e plotë në DPV 2017. Kjo marrëdhënie është ende në proces, sendi i shënuar në kontratë nuk ka përfunduar, dhe nuk ka ende asnjë të drejtë reale mbi të, nuk ka ndonjë regjistrim të pasurisë në favor të subjektit të rivlerësimit dhe për rrjedhojë nuk ka çfarë të deklarohet. Kërkimi për paraqitjen e provave në kuadër të barrës së provës, për rrethanat mungesore nuk mund të realizohet, në kushtet kur nga Komisioni janë bërë kërkime në të gjitha zyrat e kadastrës së vendit dhe ka përgjigje negative për pasuri të paluajtshme në emër të subjektit apo personave të lidhur me të.*

69.1. Në kushtet kur, me dërgimin e prapësimeve, subjekti nuk depozitoi dokumentacionin e kërkuar, gjatë seancës dëgjimore të datës 6.1.2020, trupi gjykues i kërkoi sërish depozitim e të gjithë dokumentacionin që disponon lidhur me këtë pasuri (kërkesë e ripërsëritur me e-mail-in e datës 8.1.2021).

69.2. Me e-mail-in e dërguar Komisionit më 8.1.2021, për këtë pasuri, subjekti depozitoi kopje të kontratës së shitblerjes⁸⁵ për *send i ardhshëm – apartament banimi në ndërtim*, datë 10.1.2017.

69.3. Nga kontrata konstatohet se, personi i lidhur, z. E.M., në cilësinë e palës blerëse të ardhshme, ka porositur nga shoqëria “****” sh.p.k. dhe subjekti “****” person fizik, pasurinë e llojit “apartament”, me sipërfaqe totale 73.81 m², në objektin e ndërtuar nga subjektet e mësipërme në lagjen “****”, Vlorë.

69.4. Në nenin 2 të kontratës “Kushtet e shitblerjes, çmimi dhe likuidimi” përcaktohet dakordësia mes palës për çmimin e shitjes në total në shumën 5,800,000 lekë dhe likuidimi i tij do të realizohet si vijon: (i) në datën e lidhjes së kontratës palët deklarojnë se është likuiduar mes tyre në formën e paradhënies, shuma 1,800,000 lekë; dhe se (ii) pjesa e mbetur në shumën 4,000,000 lekë do të likuidohet nëpërmjet një kredie bankare, që blerësi është interesuar të përfitojë.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm lidhur me mosdeklarimin e (3) tri pasurive të paluajtshme të referuara si më sipër

70. Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka dhënë të njëjtat shpjegime lidhur me mosdeklarimin e tri asetëve të mësipërme – të drejtave reale mbi to, në deklaratat periodike vjetore dhe në atë “Vetting”, në thelb të të cilave vihet theksi te fakti se këto pasuri nuk janë marrë në dorëzim, nuk janë finalizuar me kontrata përfundimtare shitjeje, nuk janë regjistruar në emër të tij apo personave të lidhur, dhe si të tilla nuk ka pasur detyrimin për deklarimin e tyre.

⁸⁵ Kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.1.2017, redaktuar nga noteri publik znj. I.B.

70.1. Në përputhje me nenin 30 të ligjit nr. 84/2016, objekt i vlerësimit të pasurisë është kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur të tij.

70.2. Ndërsa, në pikën 1 të nenit 31 të ligjit nr. 84/2016 përcaktohet se subjekti i rivlerësimit plotëson deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 bashkëlidhur këtij ligji, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon pranë ILDKPKI-së. Kjo deklaratë plotësohet bazuar në pikat 11 dhe 19 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, si edhe në përputhje të plotë me ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe udhëzimit nr. 4095 prot., datë 10.10.2016 të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së “Për mënyrën e deklarimit të pasurive në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrimin për deklarimin e pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016”.

70.3. Qëllimi i ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 është përcaktimi i rregullave për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, të legjitimitetit të burimeve të krijimit të saj, detyrimeve financiare për të zgjedhurit, nëpunësit publikë, për familjarët e tyre dhe për personat e lidhur me ta⁸⁶. Bazuar në nenin 4 të këtij ligji, subjekti ka/ka pasur detyrimin të deklarojë: (i) pasuritë e paluajtshme dhe të drejta reale mbi to, sipas Kodit Civil; (ii) detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj; (iii) çdo shpenzim të deklarueshëm, sipas vlerave të përcaktuara ndër vite nga legjislatori.

70.4. Në këtë kuptim, megjithëse nuk u provua tej çdo dyshimi të arsyeshëm se subjekti i rivlerësimit ka patur të drejta reale mbi këto pasuri – të drejtën për ta gëzuar, disponuar apo poseduar sendin, Komisioni vlerëson se, për sa kohë janë ka kryer pagesa dhe kanë lindur detyrime financiare ndaj të tretëve, subjekti ka pasur detyrimin për deklarimin e këtyre pasurive, si edhe të dhënave financiare lidhur me to, si çmimin, pagesën e kryer, apo detyrimin e mbetur. Për më tepër, Komisioni çmon se subjekti ka pasur/ka detyrimin të deklarojë edhe shoqërinë/shoqëritë apo individët me të cilët ka hyrë në marrëdhënie kontraktuale, kjo, në kuptim të verifikimeve që mund të mbahen nga ILDKPKI-ja apo Komisioni, në përputhje me ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005.

70.5. Komisioni vlerëson se, mosdeklarimi ndër vite i këtyre marrëdhënieve juridike, si edhe të dhënave financiare lidhur me to, duket se shmang mundësinë e kontrollit nga ILDKPKI-ja dhe në rastin e mosdeklarimit të tyre në deklaratën “Vetting” (shtojca 2) për efekt të procesit të rivlerësimit kalimtar, duket se kemi të bëjmë me një përpjekje për shmangien e hetimit administrativ mbi ligjshmërinë e burimit të pagesave të kryera për këto pasuri, si edhe verifikimit të mundësisë së konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit me subjektet me të cilat ka hyrë në marrëdhënie kontraktuale.

70.6. Parë në dritën e konkluzioneve të mësipërme, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për kryerjen e pagesës së këstit të parë për prenotimin e njësisë së shërbimit në vitin 2010, si edhe faktit se gjatë gjithë procesit nuk është treguar bashkëpunues, Komisioni ngre dyshime të arsyeshme se mosdeklarimet e këtyre pasurive ndër vite dhe në deklaratën “Vetting” janë të qëllimshme, në përpjekje për të shmangur kontrollin mbi to dhe, si rrjedhim, verifikimin e ligjshmërisë së burimit të të ardhurave për pagesat e kryera për shlyerjen e çmimit të përcaktuar në kontratat respektive.

⁸⁶ Referohu nenit 1 të këtij ligji.

70.7. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm lidhur me këto pasuri, duke u gjendur në kushtet e nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016, çka përbën shkak për shkarkimin e tij nga detyra.

71. ZVRPP-ja Durrës⁸⁷ informon se në emër të personit të lidhur, bashkëshortes, znj. Gj.M., rezulton e regjistruar në bashkëpronësi pasuria e llojit “apartament” me sipërfaqe 79.93 m², nr. pasurisë ***, vol. ***, faqe ***, zona kadastrale ***.

71.1. Nga verifikimi i dokumentacionit, pjesë e dosjes së dërguar nga ZVRPP-ja Durrës lidhur me këtë pasuri, konstatohet se personi i lidhur zotëron 1/5 pjesë të kësaj pasurie përfituar në vitin 2014 nga trashëgimia ligjore⁸⁸ dhe se, më parë kjo pasuri ka qenë përfituar me anë të ligjit të privatizimit nga familjarët e saj.

71.2. I pyetur nga Komisioni lidhur me këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ndër të tjera deklaroi se⁸⁹, nuk kanë poseduar, disponuar dhe gëzuar asnjë banesë tjetër apo të kenë patur ndonjë të drejtë tjetër reale (përfshirë banesën në Tiranë të cilën e kanë shitur) të ndonjë banese tjetër, duke përfshirë edhe atë çfarë është regjistruar në ZRPP-në (Kadastër) Durrës. Për rrjedhojë, nuk kanë pasur ndonjë njoftim për pjesët takuese sipas dëshmisë së trashëgimisë.

71.3. Gjithsesi, duke mbajtur në konsideratë faktin se pjesa takuese e bashkëshortes mbi këtë pasuri është përfituar nga trashëgimia ligjore dhe se më parë rrjedh nga privatizimi, nga familjarët e saj, pra nuk ka dyshime për krijimin, trupi gjykues vlerëson se mosdeklarimi është pa pasojë dhe, si i tillë, nuk është mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar.

72. Kredi të padeklaruara/transaksione të dyshimta të personit të lidhur, djalit të subjektit

72.1. Komisioni konstaton se në deklarin periodik të vitit 2006, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar 2 kredi të marra nga djali i tij në Bankën Popullore, në shumat 150,000 lekë (likuiduar brenda vitit) dhe 290,000 lekë (likuiduar në vitin 2007).

72.2. Referuar të dhënave të dërguara nga BKT-ja, në llogarinë (nr. ***) në lekë të personit të lidhur – djalit të subjektit, z. E.M., ndër të tjera, janë regjistruar transaksionet:

- i. në datën 25.3.2014 është kredituar shuma 2,006,000 lekë me përshkrimin “Y.H., kalon E. M., për ekzekutim vendimi”;
- ii. në datën 24.10.2014, është depozituar *cash* në llogarinë e mësipërme shuma 500,000 lekë, me përshkrimin “K. Sh., depoziton për E.M.”;
- iii. në datën 29.12.2015, është transferuar nga G.I., shuma 744,220 lekë, me përshkrimin “G.I., kalon për dhënie borxhi për E. P.Malaj”;
- iv. në datën 29.2.2016, është depozituar *cash* në llogarinë e mësipërme shuma 850,000 lekë, me përshkrimin “K. Sh., derdh në llogari për E. M.”;
- v. në datën 7.4.2016, është kredituar llogaria në shumën 1,001,189 lekë, me përshkrimin “E.M., transfertë në mbërritje nga A.B., shuma e ardhur 8250,43 USD”;
- vi. në datën 20.5.2016, është depozituar *cash* në llogarinë e mësipërme shuma 605,000 lekë, me përshkrimin “E.C., sa derdh në llogari për E.M., për pagesa”.

⁸⁷ Shkresa nr. *** prot., datë 12.2.2019.

⁸⁸ Dëshmia e trashëgimisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.11.2014.

⁸⁹ Përgjigjja e pyetjes nr. 12 të pyetësorit nr. 3.

72.3. I pyetur nga Komisioni lidhur me qëllimin e këtyre transaksioneve për/nga personi i lidhur, për si edhe për marrëdhënien e djalit të tij me transferuesit/përfituesit e transfertave, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, deklaroi se⁹⁰ një pjesë e këtyre transaksioneve kanë qenë të lidhura me aktivitetin si avokat (transaksioni i datës 25.3.2014) si dhe gjatë ushtrimit të veprimtarisë në fushën e tregtisë bar-kafe, në Tiranë dhe Vlorë, ndërsa për sa i përket transaksioneve në datat 24.10.2014, 29.12.2015 dhe 20.5.2016 ka deklaruar se kanë qenë përkatësisht: hua pa interes (kusht për aplikimin për vizë amerikane); hua pa interes, për formë konsumi kryesisht udhëtimi, shlyer më pas dorazi nëpërmjet kredive konsumatore; transaksioni mund të jetë ndonjë veprim bankar në kuadër të kredive konsumatore të marra nga djali në banka apo fondacione.

72.4. Në lidhje me transaksionin e datës 7.4.2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se shuma është dhuratë nga ish-e fejuara A.B., e cila jeton në Kanada. Qëllimi i dhuratës konsumatore për vizitë jashtë shtetit (Europiani 2016).

72.5. Me dërgimin e prapësimeve, subjekti i rivlerësimit i ka qëndruar shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit dhe depozitoi dokumentacion provues⁹¹ për transfertën e kryer në favor të personit të lidhur në datën 25.3.2014, në vlerën 2,006,000 lekë (si më sipër).

72.6. Pasi shqyrtoi me paanësi dhe objektivitet shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit si edhe provat e depozituara lidhur me transaksionet si më sipër, Komisioni konstaton se:

- i. subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur nuk ka deklaruar në DPV-të përkatëse vjetore shumat e pretenduara si të marra hua si edhe kronologjinë e shlyerjes së tyre. Në deklaratën “Vetting” nuk rezulton të ketë deklaruar hua të marra dhe detyrime të mbetura ndaj individëve;
- ii. subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të provuar deklaratimet e tij lidhur me këto huamarrje të pretenduara, si edhe për ligjshmërinë e burimeve financiare të huadhënësve të pretenduar;
- iii. subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur nuk ka deklaruar dhurime (as në DPV-vjetore dhe as në deklaratën “Vetting”), si edhe nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të provuar deklaratimet e tij lidhur me dhurimin e pretenduar, si edhe për ligjshmërinë e burimeve financiare të huadhënësve të pretenduar.

73. Agjencitë ligjzbatuese kanë informuar se në datën 5.11.2015 personi i lidhur, E. M., ka deklaruar në pikën e kalimit kufitar Rinas shumën 10, 300 euro, me përshkrimin: “blerje pajisjesh për hapje lokali”. Destinacioni: Barcelonë, Spanjë.

73.1. Konfirmohet se në datën 4.11.2015 është regjistruar në QKB subjekti “****” person fizik, me Nipt ***, me emër tregtar “*****”, për ushtrimin e aktivitetit “Bar - bufe”.

73.2. Rezulton se në DPV/2015 subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur në përputhje me ligjin e deklaratimit të pasurive, nuk ka deklaruar shpenzime në vlerë mbi 300,000 lekë.

⁹⁰ Përgjigjja e pyetjes nr. 13 të pyetësorit nr. 3.

⁹¹ (i) Vendimi nr. ***, datë 5.3.2012, i Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Vlorë; (ii) Prokurë e posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.7.2013; (iii) vendimi nr. ***, datë 17.9.2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Subjektit iu kërkuan shpjegime lidhur me mosdeklarimin e këtyre shpenzimeve, si dhe iu kalua barra e provës për të deklaruar dhe dokumentuar burimin e krijimit të kësaj shume.

73.3. Me dërgimin e prapësimeve lidhur me këtë çështje, subjekti deklaroi se *shuma 10.300 euro edhe pse është marrë me qëllimin për blerje të pajisjeve të lokalit bar “****”, nuk është konsumuar, dhe për rrjedhojë, nuk ka qenë detyrimi për deklarim të shpenzimeve në vlerë mbi 300,000 lekë.*

73.4. Por, Komisioni vëren se subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj shume dhe, si rrjedhojë, nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat, të cilat kanë mundësuar krijimin e saj, duke mos u treguar bashkëpunues në kuptim të nenit 48 të ligjit 84/2016.

74. Në lidhje me deklarimin e likuiditeteve gjendje në llogari bankare ndër vite të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur si edhe shtesat dhe pakësimet e tyre, Komisioni konstaton pasaktësi ndër vite në deklarimin e tyre, si më poshtë vijon:

- i. në DPV/2004, nuk është deklaruar pakësimi apo destinacioni i vlerave monetare në bankë në shumën 500.000 lekë, deklaruar gjendje në deklaratën fillestare të pasurisë;
- ii. në DPV/2005, nuk janë deklaruar shtesa/pakësime/gjendje në llogaritë bankare dhe *cash*, konkretisht depozita në emër të bashkëshortes, si dhe llogaria rrjedhëse në lekë në “Raiffeisen Bank”, përkatësisht në shumën 300,000 lekë dhe 250,087 lekë (gjendje në datë 31.12.2005);
- iii. në DPV/2006, nuk është deklaruar pakësimi/zvogëlimi i këtyre vlerave monetare në “Raiffeisen Bank” si më sipër, si gjendje në vitin 2005;
- iv. në DPV/2007, nuk janë deklaruar shtesa/pakësime/gjendje në llogaritë bankare, e konkretisht (i) gjendje në llogari në “ISP bank” në emër të subjektit shuma 2,021.28 euro dhe; (ii) gjendje në llogari në “Tirana Bank” në emër të bashkëshortes, shuma 100,125 lekë.
- v. në DPV/2008, nuk janë deklaruar shtesa/pakësime/gjendje në llogaritë bankare, e konkretisht (i) gjendje në llogari në “ISP Bank” në emër të subjektit shuma 3,159.29 euro; (ii) gjendje në llogari në “Raiffeisen Bank” në emër të bashkëshortes shuma 100,000 lekë dhe; (iii) gjendje në llogari në BKT në emër të djalit shuma 43,622 lekë.
- vi. në DPV/2009, nuk janë deklaruar shtesa/pakësime/gjendje në llogaritë bankare, e konkretisht: (i) gjendje në llogari në “ISP Bank” në emër të subjektit shuma 3,326.49 euro; (ii) gjendje në llogarinë në “Raiffeisen Bank” në emër të bashkëshortes, shumat 125,000 lekë dhe 50,023 lekë; (iii) gjendje në llogarinë në “Tirana Bank” në emër të bashkëshortes, përkatësisht shumat 175,000 lekë dhe 75,000 lekë dhe; (v) gjendje në llogari në BKT të djalit shuma 90,077 lekë.
- vii. në DPV/2010, nuk janë deklaruar shtesa/pakësime/gjendje në llogaritë bankare, e konkretisht: (i) gjendje në llogari në “ISP Bank” në emër të subjektit shuma 5.681.33 euro; (ii) gjendje në llogari në “Raiffeisen Bank” në emër të subjektit shuma 67,111 lekë; dhe (iii) gjendje në llogari në BKT në emër të djalit shuma 89,258 lekë.
- viii. në DPV/2011, nuk janë deklaruar shtesa/pakësime/gjendje në llogaritë bankare, e konkretisht: (i) gjendje në llogari në “ISP Bank” në emër të subjektit shuma 203.4 euro; dhe (ii) gjendje në llogari në BKT në emër të djalit shuma 88,438 lekë.

Analiza financiare për vitet 2003 – 2016

75. Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI si edhe në përgjigje të pyetësorëve, të dërguar gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën paraprake të treguesve financiarë mbi pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur, për çdo vit, për periudhën 2003 – 2016, nga ku rezulton se edhe vitet 2005, 2006, 2010, 2011, 2012, 2013 dhe 2015 paraqiten me balancë negative të fondeve në vlera të konsiderueshme.

75.1. Pas kalimit të barrës së provës dhe me dërgimet e prapësimeve të subjektit, të shoqëruara me shpjegime dhe prova për analizën e treguesve financiarë si dhe për mundësinë e pagesave për asetet e trajtuara më sipër, Komisioni pasqyroi reflektimet përkatëse, duke reduktuar shpenzimet e udhëtimit për vitet 2005 dhe 2011.

75.2. Si përfundim, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të paraqiten me pamundësi financiare për të justifikuar plotësisht me të ardhura nga burime financiare të ligjshme pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera, për vitet 2005, 2006, 2010, 2011, 2012, 2013 dhe 2015, të pasqyruara balancat negative të fondeve si vijon⁹²:

- (i) viti 2005 balanca negative e fondeve (- 750,328 lekë);
- (ii) viti 2006 balanca negative e fondeve (- 95,026 lekë);
- (iii) viti 2010 balanca negative e fondeve (-3,531,315 lekë);
- (iv) viti 2011 balanca negative e fondeve (- 1,192,420 lekë);
- (v) viti 2012 balanca negative e fondeve (- 469,549 lekë);
- (vi) viti 2013 balanca negative e fondeve (-1,959,261 lekë); dhe
- (vii) viti 2015 balanca negative e fondeve (- 3,612,887 lekë).

Konkluzioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë

76. Si përfundim, mbështetur në rrethanat e faktit dhe të dhënat e mbledhura gjatë hetimeve, si dhe provat shkresore të administruara në dosje, lidhur me kriterin e vlerësimit pasuror, trupi gjyqësor arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit:

- i. ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e krijuara ndër vite; dhe
- ii. ka kryer deklaratim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë, çka përbën shkak për shkarkimin nga detyra, në përputhje me pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

ÇËSHTJE TË TJERA

77. Marrëdhënia e huas me shtetasin S. Sh.

77.1. Gjatë hetimit administrativ u konstatua se në datën 3.12.2011 subjekti i rivlerësimit ka marrë hua⁹³ nga shtetasi S.Sh., shumën 40,000 dollarë.

Rezulton se, kjo hua nuk është deklaruar në DPV-të vjetore dhe as në deklaratën “Vetting”. Nuk është deklaruar destinacioni, kronologjia e shlyerjes së saj dhe detyrimi i mbetur, nëse ka. Subjekti nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të provuar ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të personit tjetër të lidhur, huadhënësit, z. S. Sh., si edhe burimet e të

⁹² Për më tepër referohu tabelës përmbledhëse të analizës financiare – bashkëlidhur aneksi 1 këtij vendimi.

⁹³ Kontrata e huas nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.12.2011.

ardhurave, të cilat kanë shërbyer për shlyerjen e kësaj huaje, në përputhje me pikën 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.

77.2. I pyetur nga Komisioni lidhur me këtë marrëdhënie huaje, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se⁹⁴ nga verifikimi dhe marrja e kopjes pranë noterit, rezulton se kjo është një kontratë huaje ku shtetasi S.Sh., ka qenë në cilësinë e huadhënësit dhe jo në atë të huamarrësit. Ishte kërkesa e tij për të marrë një hua tek ky biznesmen, por edhe pse u formulua ne zyrën e noterit, nuk u ekzekutua, sepse huadhënësi nuk e dha këtë shumë dhe palët u tërhoqën. Për këtë shkak nuk ka asnjë veprim bankar apo veprim tjetër financiar për kryerjen e pagesës apo për pagesa këstesh prej tij. Kjo ka qenë edhe arsyeja e mosdeklarimit të këtij akti noterial. Me personin e mësipërm nuk ka asnjë marrëdhënie të veçantë, janë komshinj, sepse ai ka një banesë (apartament) ngjitur me të, në të njëjtin kat tek pallati “***”, dhe njihet në qytetin e Vlorës si biznesmen.

77.3. Por ndërkohë, referuar kontratës së huas **konstatohet se në të është përcaktuar se shuma 40,000 dollarë është marrë nga huadhënësi jashtë zyrës noteriale.**

I pyetur lidhur me këtë fakt, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se⁹⁵ në përgjigjet e mëparshme (u referohet përgjigjeve të pyetësorit nr. 2) ka deklaruar rrethanat konkrete të vërteta të kësaj kontrate, e cila nuk u realizua. Më vonë, sidomos së fundmi i ka kërkuar shtetasit S. Sh., për deklarimin e faktit që shuma nuk u mor prej tij, veprim që është materializuar me deklaratë noteriale (depozituar prej tij në Komision)⁹⁶. Përcaktimet që bëhen në kontratën e huas për marrjen e shumës, janë përcaktime shabllone që përdoren, me sa ka dijeni, në gjithë kontratat e këtij lloji. Në dijeninë e tij, nuk di të ketë pasur ndonjë marrëdhënie të posaçme me këtë shtetas për shkak të detyrës.

77.4. Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit u qëndron shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ lidhur me këtë marrëdhënie huaje, duke shtuar se kjo kontratë, e cila është bërë me akt noterial, është prapësuar po me akt noterial të të njëjtit nivel.

77.5. Në vlerësim përfundimtar lidhur me këtë marrëdhënie, edhe nëse merren të mirëqena pretendimet e subjektit se shuma e përcaktuar në kontratën e huadhënies nuk është marrë prej tij, duke konsideruar se kontrata nuk është revokuar⁹⁷, trupi gjykues çmon se kjo marrëdhënie e ka vendosur subjektin e rivlerësimit në kushte të tilla që, huadhënësi mund ta vinte lehtësisht nën presion duke i kërkuar zbatimin e kontratës, pra, kthimin e shumës, të cilat nuk mund të pajtohen me funksionin e tij si prokuror dhe përbën shkak për cenimin e besimit të publikut, në kuptim të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2014.

78. Çështja me të pandehur z. A.H.

78.1. Nga hetimi administrativ i kryer ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, z. Pelivan Malaj, në periudha të ndryshme ka udhëtuar apo ka përdorur disa automjete.

I pyetur lidhur me përdorimin e këtyre mjeteve, për shtetasit që i kanë pasur në pronësi apo që e kanë shoqëruar gjatë udhëtimeve dhe marrëdhënien me to, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se⁹⁸ *mjeti me targë AA ***, është autoveturë në dijeninë e tij në pronësi të*

⁹⁴ Përgjigjja e pyetjes nr. 11 të pyetësorit nr. 2.

⁹⁵ Përgjigjja e pyetjes nr. 7 e pyetësorit nr. 3.

⁹⁶ Deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.2.2020.

⁹⁷ Rezultoni vetëm deklaratë noteriale e z. S. Sh., e datës 6.2.2020 e hartuar gjatë hetimit administrativ të kryer për këtë subjekt, deklaratë e bërë rreth 9 vjet e një muaj pas nënshkrimit të kontratës së huas.

⁹⁸ Referohu përgjigjes së pyetësorit nr. 4.

shtetasi A. H., i cili ka qenë edhe drejtues i mjetit, udhëtim privat triditor (edhe me traget) datë 14.03.2013, së bashku me kolegun E.H., për tek vajza tij A.H., që ndiqte studimet e larta në Milano (Itali). Lidhur me shtetasin A.H., në shkurt të vitit 2015 dhe dhjetor të vitit 2018, ka përfaqësuar dy çështje penale gjatë gjykimit në Apel, përkatësisht një për masën e sigurimit dhe një gjykim në themel, për të cilat deklaroi se ka mbajtur qëndrim ligjor, duke ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

78.2. Komisioni administroi dosjen e plotë të procedimit penal⁹⁹ ku ndër të tjerë, si i pandehur është shtetasi A.H., dhe në të cilën subjekti i rivlerësimit ka përfaqësuar Prokurorinë e Apelit Vlorë në caktimin e masës së sigurimit personal ndaj këtij shtetasi dhe gjatë gjykimit në themel të çështjes.

78.3. Nga analiza përfundimtare e shpjegimeve të dhëna nga subjekti gjatë hetimit administrativ dhe me dërgimin e prapësimeve pas dërgimit të rezultateve të hetimit, pa i hyrë themelit të çështjes, Komisioni çmon se subjekti ka qenë në kushtet e parashikuar në nenin 26 të Kodit të Procedurës Penale “Heqja dorë e prokurorit”, sipas të cilave ka pasur për detyrë të heqë dorë nga përfaqësimi i akuzës në caktimin e masës së sigurimit dhe gjykimin në themel të kësaj çështjeje, për shkak se duket se ekzistojnë arsye njëanësie. Pra, duket se qëndrimi i prokurorit Malaj përbën shkak për cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, në kuptim të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2014.

V. KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara prej tij, nga vlerësimi tërësor arrin në përfundimin se **subjekti nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, nuk është treguar bashkëpunues gjatë procesit të rivlerësimit dhe se, me veprimet dhe mosveprimet e tij ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.**

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 2 të nenit 4, si edhe pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar nenit 48, nenit 58, pika 1, germa “c”, si dhe të nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Pelivan Malaj, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

⁹⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 9.11.2020 e Prokurorisë së Apelit Vlorë dhe shkresë nr. *** prot., datë 30.10.2020 e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, nëpërmjet të cilave është dërguar dosja e këtij procedimi penal.

3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më 11.1.2021

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Lulzim HAMITAJ
Kryesues

Valbona SANXHAKTARI
Anëtare

Pamela QIRKO
Relatore

Gledis HAJDINI
Sekretare gjyqësore

ANEKS 1 - ANALIZA FINANCIARE PËRMBLEDHËSE

Nr	Pershkrimi	Viti 2003	Viti 2004	Viti 2005	Viti 2006	Viti 2007	Viti 2008	Viti 2009	Viti 2010	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	
	Perberja familjare (certifikate)	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	
ASETE	Pasuri të Paluajtshme															
	Apartament ne Vlore me sip.57.8 m2 nga privatizimi, shitur ne date 27.10.1999															
	Apartament, dy dhoma dhe një gëzhinë, sipërfaqe 120 m2, lagja "XXX" Vlore															
	Zyrë avokatie me sip.20 m2, ndërtuar në vitin 1996															
	Ap. me sip.75 m2, në Farkë Tiranë, porositur tek shoq. "XXX"kontrate viti 2005 për shumën 45.000 euro				3 553 660	1 362 350				693 850						4 937 000
	Zyrë avokatie prenotuar tek shoqëria XXX shpk në vitin 2010									9 339 221						
	Ap. në Luginë XXX Vlorë me sip.73.8 m2, kont. dt. 15.12.2015.															6 300 000
	Autoveture Golf 2, me targë XXX, Blere ne vitin 2000 për 400,000 lekë, nxjerrë jashtë përdorimit viti 2004 deklaruar															
	Autoveture Renault Tëingo blerë në vitin 2003, dorezuar targat ne vitin 2014		348 000													
	Autoveture Renault Clio GRI blerë në vitin 2014, shitur ne dhjetor 2015															
	Autoveture tip Lancia blere ne date 16.01.2013 me targë XXX shitur në datë 03.04.2014													280 280		280 280
	Autoveture Jaguar blerë në vitin 2013 në shumën 6500 euro nga E.M												100 000			100 000
	Autoveture Mercedes Benz viti 1992 me targë XXX			350 000									911 365			
	Autoveture Mercedes Benz XXX viti 2001 blerë në date 14.12.2015 në shumën 2000 euro															274 560
	Likuiditete (ndryshim gjendje)				553 173	586 548	346 924	312 864	342 990	26 243	818 824	5 928	31 923	92 367	98 989	20 517
Huadhënie																
Asete të tjera																
TOTALI		348 000	350 000	4 106 833	775 802	346 924	312 864	342 990	10 006 828	818 824	5 928	979 442	87 913	6 195 291	4 916 483	
DETYRIME	Kredi Bankare Raiffeisen Sr disbursim 2008						77 742	33 327	40 639	3 776						
	Kredi Bankare Raiffeisen Sr disbursim 2010								414 780	414 780						
	Kredi Banka Amerikane, Sr disbursuar në dhjetor 2005			2 450 800	163 565	167 797	180 972	235 836	401 059	408 624	406 063	512 176	510 686	508 609	242 468	
	Kredi Banka Amerikane Sr disbursuar ne nentor 2010								5 520 597	399 613	427 557	437 203	476 134	508 211	544 153	
	Kredi Bankare E.M. në B.Populore dist.vit 2006,shuma150000 lek. lik brenda vitit me kredi ne vlore 290.000, date 27.11.2006				267 710	267 710										
	Kredi Bankare E.M. në NBG disbursuar në vitin 2007 shuma 400.000 Lekë					400 000	83 528	316 472								
	Kredi Bankare Raiffeisen E.M., disbursuar në vitin 2009 shuma 1,000,000 Lek							948 371	93 263	855 108						
	Kredi Bankare Fondi Besa E.M. shtator 2014													950 000	950 000	
	Kredi Bankare BKT E.M., disbursuar në 31.12.2015, shlyer 2016														5 000 000	
	Huamarrje															
	Detyrime shoq. Nderimit														1 064 740	
TOTALI				2 450 800	104 145	35 507	186 758	362 736	6 202 534	2 081 900	833 620	949 379	36 820	4 097 921	5 301 685	
TE ARDHURA	Paga nga funksioni	558 244	1 152 159	1 138 777	1 117 502	1 113 129	1 143 471	1 160 926	1 208 906	1 160 137	1 210 552	1 167 234	1 239 592	1 245 084	1 230 663	
	Te ardhura bashkeshortija	112 038	122 064	132 671	138 264	141 726	147 414	144 726	160 182	166 584	169 848	179 585	165 413	143 204	195 735	
	Paga e familjareve djali paga						448 617	180 294							614 658	
	Te ardhura djali si avokat (fitim)													5 930	35 928	
	Te ardhura djali nga biznesi me NIPT XXX (fitim neto)														175 201	
	Shperblime neto sr											128 000				
	Te ardhura nga Qira, kompesim kembim prone															
	Te ardhura nga interesat bashkeshorte RZB			10 886	11 435				5 219	6 198						
	Te ardhura nga interesat (bashkeshortija Tirana Bank)								7 649	14 573						
	Te ardhura nga shitja e pasurive te paluajtshme															
	Te ardhura nga shitja e pasurive te luajtshme															
	Te ardhura nga shitja e automjetit Mercedes Benz viti 1992 me targë XXX													140 140		
	TOTALI	670 282	1 274 223	1 282 334	1 267 201	1 254 855	1 739 502	1 509 120	1 389 859	1 326 721	1 508 400	1 346 819	1 539 215	1 599 417	4 353 441	
	SHPENZIME	Pagesë interesa kredie SR Raiffeisen disbursim 2008							16 848	12 607	5 295	63				
Pagesë interesa kredie SR Raiffeisen disbursim 2010										5 399	18 258					
Pagese interesa Banka Amerikane Sr për kredi disbursuar ne dhjetor 2005					204 449	210 919	215 089	184 418	161 387	154 599	135 293	79 966	50 371	17 940	260	
Pagese kest kredie interesa Bankare Amerikane Sr disbursuar në nëntor 2010									34 538	378 256	357 782	392 448	352 781	303 482	256 391	
Kredi Bankare E.M., ne B.Populore disbursuar 2006,likujduar brenda vitit					17 450	26 860										
Pagese kest kredie interesa Bankare E.M., në NBG disbursuar në 2007							42 453	2 813								
Pagese kest kredie interesa Bankare E.M., në Raiffeisen disbursuar në 2009								164 654	221 130	197 778						
Pagese kest kredie interesa Bankare E.M., Fondi Besa shtator 2014														91 000	131 700	
Pagese kest kredie interesa Bankare E.M., në BKT viti 2015																
Shpenzime bileta, udhëtime, sr dhe bashkeshortija							106 468	197 421	45 794	97 251	90 036	152 128	95 660	63 890	123 735	
Shpenzime bileta, udhëtime, djali											112 859	259 389	30 851	370 118	327 042	
Sisime, transport											23 786	23 163	13 958	29 634	34 514	
Shpenzime te tjera				47 958					20 000	93 475		25 238			79 500	
Shpenzime investime të tjera djali															1 413 984	
Humbje nga Kureset e këmbimit															265 211	
Shpenzim vleresime, rivleresimi, arredime, bl pajisje						140 000	140 000	140 000	140 000	140 000				21 857	21 857	
Shpenzime INSTAT, ILDKPIK	281 892	281 892	328 671	328 671	328 671	328 671	328 671	409 860	409 860	409 860	418 644	423 072	659 994	672 828		
TOTALI	281 892	281 892	376 629	690 570	747 043	930 718	1 131 773	1 116 879	1 256 065	1 138 399	1 377 260	1 316 451	3 114 934	2 059 859		
ANALIZA FINANCIARE		Viti 2003	Viti 2004	Viti 2005	Viti 2006	Viti 2007	Viti 2008	Viti 2009	Viti 2010	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	
1 Te ardhurat		670 282	1 274 223	1 282 334	1 267 201	1 254 855	1 739 502	1 509 120	1 389 859	1 326 721	1 508 400	1 346 819	1 539 215	1 599 417	4 353 441	
2 Asete		348 000	350 000	4 106 833	775 802	346 924	312 864	342 990	10 006 828	818 824	5 928	979 442	87 913	6 195 291	4 916 483	
3 Detyrimet		-	-	2 450 800	104 145	35 507	186 758	362 736	6 202 534	2 081 900	833 620	949 379	36 820	4 097 921	5 301 685	
4 Shpenzime te deklaruar		281 892	281 892	376 629	690 570	747 043	930 718	1 131 773	1 116 879	1 138 399	1 377 260	1 316 451	3 114 934	2 059 859		
Balanca e fondeve (1-2+3-4)		40 390	642 331	- 750 328	- 95 026	125 380	309 162	397 094	- 3 531 315	- 1 192 420	- 469 548	- 1 959 261	98 031	- 3 612 887	1 908 380	